

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5773  
E premte, 10 maj 2019  
çmimi 0.40 €

Kërkohej që Dita e Evropës të mos jetë festë zyrtare në Kosovë | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DUKAGJIN GORANI | FAQE 4-5

## Fati i qeverisë është i lidhur ngushtë me dialogun Kosovë - Serbi



Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), po ashtu deputet i kësaj partie, Dukagjin Gorani, ka bërë me dije se fati i koalicionit qeverisës është i lidhur ngushtë me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai

ka thënë se vazhdimi i këtij procesi përbën edhe arsyen kryesore të formimit të këtij koalicioni. Për këtë arsye, sipas tij, nuk duket të ketë ndonjë interesim real, as lokal e as ndërkombëtar për rrëzimin e këtij koalicioni. Gorani ka treguar se opozita parapëlqen mundësinë që

kjo qeveri ta përmbyllë këtë proces nga frika se rezultati i tij do të jetë i pakëndshëm për vendin, kurse qeveria përpiqet ta shohë të kundërtën. Dukagjin Gorani ka theksuar se qeverisja aktuale paraqet version paksa më të banalizuar të traditës së qeverisjeve të deritashme

### AKTUALE

#### EKONOMIA 'VULOS' POLITIKËN | F.11



Nga Xhavit HALITI

#### KËNGA E MJELLMËS E MASHTRUESVE NGA BRUKSELI, BEOGRADI, PRISHTINA DHE TIRANA | F.11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

#### NË DITËN E EVROPËS BËHET THIRRJE PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR QYTETARËT E KOSOVËS | F.7

#### AMBASADORJA GECI-SHERIFI DORËZOI KRENCIALET TE MBRETI I SUEDISË | F.6

### EKONOMI



#### VDEKJET DHE LËNDIMET NË VENDIN E PUNËS, SHQETËSUESE, PEZULLOHEN MBI 100 VENDPUNISHTE | F.9

#### 100 FERMERË TË RINJ NGA GJILANI DHE KUMANOVA TRAJNOHEN NË NDËRMARRËSI | F.9

### SPORT

#### HYSENI: HOVI I FERIZAJT NDALET NË MITROVICË | F.18

## Udhëheqësit e Brdo-Brijunit kërkojnë përsheptimin e procesit integruar për Ballkanin



FAQE 3



## Haradinaj: UÇK-ja i ka pasur të rrallë heronjtë si Konushevcin e Malajn | FAQE 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# EKONOMIA “VULOS” POLITIKËN



Nga Xhavit HALITI

D y ngjarje të mëdha, me efekte historike për Kosovën, na kanë vënë në vëmendjen e politikës botërore: çlirimi dhe pavarësia! Por, po bëhen disa vite që "shqetësimi" e "përkujdesja", e miqve ndërkombëtarë dhe aleatëve tanë të çmuar kanë filluar "të zbehën". U frenuan, për të mos thënë që, në ndonjë rast, njohjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, edhe janë pakësuar. Vazhdon, edhe 11 vjet pas shpalljes së pavarësisë, mosnjohja e saj nga 5 anëtare të BE-së. U shamng, si rrjedhojë e "historisë", "peshës" dhe "ndikimit" të Serbisë anëtarësimi në Interpol. U zvarritën dhe nuk dhanë rezultatin e pritshëm bisedimet disaveçare Kosovë- Serbi nën kujdesin e BE-së. Politika jonë shtetërore dhe ajo ndërkombëtare kanë sugjeruar dhe janë përpjekur të gjejnë një zgjidhje për ngërçin politiko- shtetëror mes Serbisë dhe Kosovës. Jemi realisht dy shtete në qendër të Evropës Perëndimore. Në "parahistorinë" më të afërt, në prag të prishjes së ish- Federatës së Jugosllavisë, kemi gëzuar të njëjtin status kushtetues në forumet e larta shtetërore, por nën emërtimin e "Krahinës Autonome", dhe jo Republikës. Kjo diferencë formale mes krahinës dhe republikës dhe, sidomos, Kushtetuta e Serbisë, vazhdon që të na konsiderojë pjesë të Republikës së Serbisë, janë fillimi dhe fundi, i mospajtimit dhe i shqetësimit në marrëdhëniet Kosovë- Serbi. Historia e shprishjes së ish -Federatës së Jugosllavisë dhe problematikat e mbetura pas saj dihen. Dihen problematikat kufitare ende të pazgjidhura, mes Kroacisë dhe Sllovenisë; Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi; Kroacisë dhe Bosnje Hercegovinës. Në këtë hapësirë historike Serbia, ish- kryeqendra e federatës, dhe realisht sunduese e Jugosllavisë, u ndje e dëmtuar politikisht, territorialisht dhe e ofenduar historikisht. Bisedimet disaveçare, të kërkuara dhe të menaxhuara nga BE-ja, mes Kosovës dhe Serbisë u ndërprejnë. Arsyeet për këtë u përligjen si nga Prishtina, edhe nga Beogradi. Shkaqet e ndërprejes qenë thuajse të njejtat: zgjedhjet "problematike" parlamentare, protestat popullore dhe mungesa e hapësirave ligjvënese. Mund të ketë qenë rastësi, por ndërprerja e bisedimeve në kohë me përjasjen nga Rusia të aneksimit prej saj të Krimesë, me "shkeputjen" e Kosovës nga Serbia. Ky akt dhe fakt me dimensione ndërkombëtare risolli në vëmendje raportin, disi më të hershëm, atë tonin me Serbinë. Kemi shumë vite që, nën "këshillimin" ndërkombëtar, po bisedojmë që Serbia të na njoh politikisht si shtet. Brukseli rezultoi jo produktiv. Në vazhdim e tejkallim të ngërçit mes paleve në "konflikt", u parashtrua një zgjidhje me dy cilësime: rishikim ose korrigjim kufijsh. Por, kur ky opsion, u vu në diskutim mes "po"-së dhe "jo"- së, pëlqimet dhe

mospëlqimet politike, institucionale dhe popullore, dhe u shfaq taksa 100% ndaj mallrave serbe të importuara nga Kosova.

Qeveria e Kosovës, që ligjerisht, në demokracitë parlamentare identifikohet me "forcën" e shtetit, miratoi dhe zbatoi taksën ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnje- Hercegovina. Për marrjen e këtij vendimi me siguri është dashur paraparakishtë konsultim, llogaritje pasojash dhe, mbi të gjitha, përgjegjshmëri. Të kufizosh importin e mallrave është normalisht në ekonominë e "tregut", fuqi ekonomike e shtetit, që mbron prodhimin vendas me subvencionim. Ne, dhe kjo dihet, jemi të pazotë për këtë, ndaj u përballëm dhe vazhdojmë të gjykohe mi për taksën!

Alarmin kundër taksës e dha Beogradi, duke e cilësuar heqjen e saj si kushtin kryesor, (për të mos thënë të vetmin), për rifillimin e dialogut. Ky kushtëzim ka qenë i efektshëm në diplomacinë dhe politikën botërore. Kundër kësaj takës janë shprehur përfaqësues të BE-së dhe SHBA-së, madje edhe krerë të insitucioneve të larta shtetërore në Kosovë dhe Shqipëri. Në përballje me të gjithë, kryeministri i Kosovës "guxon" të insistojë në vendimin për taksën, që u mor me objektivin e shprehur qartë dhe hapur: "Do të hiqet ditën që Serbia do të njoh zyrtarisht dhe botërisht shtetin e Kosovës".

Nuk gjykoj dot për këtë qëndrim e vendim. Por, mendoj dhe vleresoj efektin real të këtij akti që, në përballje me opsionet e përfolura politike e mediatike për "rishikim", "ndryshim" dhe "korrigjim kufijsh" mes dy shteteve, shpalli dhe po mban sovraitetin shtetëror përmes ekonomisë. Kjo taksë na rikthen në vëmendjen e Evropës dhe të Botës, kuptohet, me ndihmën e ndieshme të "alarmit" të Serbisë për të.

Jemi shtet i vogël dhe më i riu në Evropë. Para 20 vjetësh ishim "oborri i pasëm" i Serbisë dhe, edhe para disa muajsh, kemi qenë tregu i saj. Kur Kosova vuri taksën për mallrat e Serbisë dhe të Bosnje Hercegovinës, dy shteteve të dala nga ish- Jugosllavia që vazhdojnë të mos e njohin si shtet te pavarur, ajo u bë e rëndësishme, u ribë subjekt bashkeveprues me BE-në dhe SHBA-në. E pse?! Politika e udhëheq ekonominë. E orienton, i hap rrugë dhe i krijon hapësirë veprimi. Ekonomia është bazamenti i besueshmërisë së politikës dhe i ecurisë së saj. Politika në Kosovë nuk arriti ta gjejë një zgjidhje të pranueshme e përfundimtare për raportet shtetërore Kosovë- Serbi.

"Çelësi" ekonomik, prezent dhe veprues edhe në Samitin e Berlinit, mendoj se mund të vlejë dhe të shërbejë për normalizimin sa më të shpejt të marrëdhënieve Kosovë- Serbi.

(Autori është nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës)

Politika e udhëheq ekonominë. E orienton, i hap rrugë dhe i krijon hapësirë veprimi. Ekonomia është bazamenti i besueshmërisë së politikës dhe i ecurisë së saj

Në Tiranë është mbajtur Samiti i Brdo-Brijunit në të cilin kanë marrë pjesë liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor

## Udhëheqësit e Brdo-Brijunit kërkojnë përshpejtimin e procesit integruar për Ballkanin

Drejtuesit e Samitit të Brdo-Brijunit nga Tirana i kanë bërë thirrje Bashkimit Evropian (BE) që ta konsiderojë integrimin e Ballkanit Perëndimor si një çështje me rëndësi gjeopolitike duke pasur parasysh se integrimi i këtyre vendeve është faktor i rëndësishëm për stabilitetin evropian. Liderët kanë mirëpritur angazhimin e kancelares Merkel dhe presidentit Makron për Ballkanin Perëndimor si dhe e kanë mbështetur qëndrimin e BE-së, se një nga kushtet për anëtarësimin e një vendi aspirues është zgjidhja e çështjeve të hapura me fqinjët. Drejtuesit e këtij samiti i kanë inkurajuar Kosovën dhe Serbinë për ta vazhduar procesin e dialogut si dhe kanë shprehur përkushtimin për paqe dhe stabilitet në rajon



EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 MAJ - Samiti i Brdo-Brijunit ka mbledhur të enjten në Tiranë presidentët e vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilët kanë shprehur aspiratën e përbashkët për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Diskutimet e liderëve ballkanikë janë fokusuar në procesin e anëtarësimit të rajonit në BE si dhe në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Nikoqiri i Samitit Brdo-Brijun, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në një konferencë të përbashkët për medie ka bërë me dije se liderët kanë diskutuar për krijimin e një hapësire tërheqëse për investime në rajon si dhe kanë shprehur angazhimin për paqen dhe qëndrueshmërinë në rajon. Meta ka thënë se zgjidhja e mosmarrëveshjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor është rruga e vetme për t'u afruar me familjen evropiane.

Duke prezantuar përfundimet e këtij takimi presidenti Meta ka thënë se udhëheqësit e Samitit të Brdo-Brijunit kanë njohur dhe pranuar se përparimi i shënuar deri më tani ka kontribuar në konsolidimin e demokracisë, të paqes,

sigurisë, stabilitetit, si dhe në rritjen e bashkëpunimit rajonal. Ai ka treguar se është mirëpritur Marrëveshja e Prespës dhe është konstatuar se një shembull i tillë i hap rrugën forcimit të lidhjeve evropiane dhe euroatlantike me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Meta ka thënë se është mirëpritur përkushtimi i BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor përmes procesit të Berlinit, Brdo-Brijunit si dhe të Parisit. "E përgëzuar Poloninë që do ta mirëpresë Samitin e ardhshëm të Procesit të Berlinit, duke konfirmuar se rajoni i Ballkanit Perëndimor mbetet parësor në krye të agjendës së Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ne përgëzuar mbështetjen aktive të Kroacisë dhe Sllovenisë dhënë ndaj perspektivës evropiane të pjesëmarrësve të Ballkanit Perëndimor dhe angazhimin e tyre për t'i dhënë përparësi rajonit gjatë presidencave të tyre të ardhshme të radhës në krye të Këshillit të Bashkimit Evropian gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 dhe në gjysmën e dytë të vitit 2021", ka deklaruar ai, duke shtuar se udhëheqësit e Brdo-Brijunit kanë mbështetur qëndrimin e BE-së se një nga kushtet për anëtarësimin e një vendi aspirues është zgjidhja e çështjeve të hapura dypalëshe me fqinjët e

vet. "Do të përpqemi në mënyrë aktive që ta vazhdojmë dialogun dhe rritjen e besimit brenda rajonit që ne përfaqësojmë. Të gjitha çështjet e hapura do të zgjidhen në mënyrë paqësore, nën frymën e respektit dhe të bashkëpunimit reciprok", ka theksuar ai.

Presidenti Meta ka thënë se liderët e vendeve të Ballkanit i kanë bërë thirrje Bashkimit Evropian që ta konsiderojë zgjerimin e tij në Ballkanin Perëndimor si një çështje me rëndësi gjeopolitike, duke pasur parasysh se integrimi i plotë i këtyre vendeve në sistemin evropian të vlerave është një faktor i rëndësishëm edhe për vetë stabilitetin e përgjithshëm evropian. Po ashtu, është kërkuar që procesi i negociatave të bëhet më i shpejtë. Meta ka treguar se kanë rënë dakord mbi nevojën për të forcuar edhe më tej proceset e dialogut dhe pajtimin në rajon bazuar në të vërtetën.

Kurse sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, ai ka thënë se kanë inkurajuar dy vendet për të vazhduar këtë proces. "Kjo temë do të jetë më e posaçme për Samitin e Parisit. Ne i inkurajojmë të dyja palët që me lehtësimin e BE-së të përqendrohen për të arit-

ur një marrëveshje të zbatueshme", ka deklaruar Meta, duke shtuar se të gjithë do të dëshironin që ky proces të kishte përfunduar. Udhëheqësit e këtij samiti janë pajtuar që Sllovenia do të jetë mikpritëseja e ardhshme e takimit të jashtëzakonshëm të udhëheqësve të procesit Brdo-Brijuni në fund të këtij viti, ku i pranishëm do të jetë edhe sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres.

Të ftuar nderi në këtë Samit kanë qenë presidenti i Polonisë, Andrej Duda dhe përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini. Me këtë rast, presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, ka thënë se BE-ja duhet t'i mbajë dyert e hapura për anëtarësimin e Ballkanit. Ai i ka ftuar Kosovën dhe Serbinë që ta vazhdojnë dialogun. "Historia e këtyre tokave është mjaft e vështirë. Këto çështje duhet të diskutohen dhe zgjidhen përmes dialogut mes liderëve dhe drejt rrugës së tyre në BE. Kjo është një detyrë e madhe e Brukselit dhe vendeve anëtare të BE-së që ta kuptojë këtë proces dhe ta mbështesin. Ky është një rol i madh që luhet nga dy vendet. Evropa Juglindore ka nevojë për Evropën dhe anasjelltas", është shprehur Duda.

Ndërsa presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović, ka thënë se shqetësues mbetet stagnimi i procesit të zgjerimit të BE-së në Ballkan. Ajo ka thënë se ky stagnim po krijon vakum të rrezikshëm për Evropën Juglindore. "Ky vakum duhet të plotësohet dhe duhet të mbushet me influencë", ka deklaruar Grabar-Kitarović, duke shtuar se BE-ja duhet t'i heqë vizat për qytetarët e Kosovës. "E mbështesim liberalizimin e vizave për Kosovën dhe hapjen e kapitujve të tjerë për vendet e tjera aspirante për anëtarësim në BE", ka thënë ajo. Ndërsa presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, ka vlerësuar se ky

takim ka ndihmuar në adresimin e çështjeve të Ballkanit. "Jam i befasuar pozitivisht nga atmosfera në sesionin plenar. Nuk po them se kemi zgjidhur probleme, por kemi adresuar probleme në një mënyrë miqësore dhe kjo është shumë e rëndësishme", ka thënë ai, duke shtuar se, pas zgjedhjeve evropiane, Brukseli duhet ta shikojë procesin e zgjerimit ndaj Ballkanit në një mënyrë tjetër.

Ndërkaq presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë fjalimit në Samitin e Brdo-Brijunit, ka folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se nuk do të ketë asociacion të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive në Kosovë. Thaçi ka thënë se marrëveshja finale ndërmjet dy vendeve nuk do të nxjerrë një Republika Srpska në Kosovë. "Çdo ditë, javë dhe muaj që kalon pa një marrëveshje të tillë, vetëm sa do të thellohet hendeku Kosovë - Serbi dhe në këtë mënyrë do të mund të ketë edhe reflektime në rajon", është shprehur Thaçi.

Presidenti Thaçi ka thënë se shpreson që takimi i Prishtinës do të ketë diçka konkrete në mënyrë që të lëvizet përpara në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Thaçi ka theksuar se nuk e ka prit mirë faktin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç ka thënë ai, nuk kanë qenë të informuara dhe koordinuara për Samitin e Berlinit. Ai ka thënë se Samiti Brdo-Brijuni po mbahet në një kohë shumë të rëndësishme për rajonin dhe për të ardhmen evropiane të vendeve. Sipas Thaçit, vendet kanë punuar për mbylljen e çështjeve të hapura dhe zgjidhjen e tyre. Ai ka vlerësuar se mosliberalizimi i vizave do të ishte i padrejtë dhe ndëshkim për popullin e Kosovës. Ai ka thënë se vendosja e taksës 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë është legjitim dhe do të mbetet në fuqi, edhe pse dialogu mes palëve duhet të vazhdojë i pakushtëzuar.



Flet për "Epokën e re", Dukagjin Gorani

# Fati i qeverisë është i lidhur nga

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), po ashtu deputet i kësaj partie, Dukagjin Gorani, ka bërë me dije se fati i koalicionit qeverisës është i lidhur ngushtë me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vazhdimi i këtij procesi përbën edhe arsyen kryesore të formimit të këtij koalicioni. Për këtë arsye, sipas tij, nuk duket të ketë ndonjë interesim real, as lokal e as ndërkombëtar për rrëzimin e këtij koalicioni. Gorani ka treguar se opozita parapëlqen mundësinë që kjo qeveri ta përmbyllë këtë proces nga frika se rezultati i tij do të jetë i pakëndshëm për vendin, kurse qeveria përpiqet ta shohë të kundërtën. Dukagjin Gorani ka theksuar se qeverisja aktuale paraqet version paksa më të banalizuar të traditës së qeverisjeve të deritashme



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 MAJ -

**"Epoka e re":** Z. Gorani, të mërkurën PSD-ja ka shënuar njëvjetorin e riorganizimit të saj. Sa sfidues ishte ky vit për këtë subjekt?

**Gorani:** Nuk ishte periudhë e lehtë marrë parasysh ambientin publik që shpeshherë është i prirë ta gjykojë një veprim para se të jetë në gjendje ta kuptojë kontekstin e tij. Për mua, përpjekja që PSD-ja të riorganizohet në një subjekt bashkëkohor ishte dëshmi e një vullneti të pasqor të shumë miqve dhe bashkëpunëtorëve, burra e gra, që ta artikulojnë një vizion politik për vendin përkundër të gjitha vështirësive. Janë pikërisht vullneti për bashkëpunim dhe vizioni i përbashkët ato që mundësojnë organizimin politik. Besoj se njerëzit e mbledhur në PSD tashmë e dëshmuar këtë.

**"Epoka e re":** Ky subjekt politik përfaqësohet në Kuvend me 12 deputetë dhe qeveris dy komuna, Prishtinën dhe Kamenicën. Çfarë e ka dalluar këtë subjekt politik nga të tjerat?

**Gorani:** Mendoj se ajo që e karakterizon PSD-në është përpjekja e vazhdueshme që të ofrojë zgjidhje të problemeve dhe vështirësive me të cilat përballet shoqëria jonë. Më

specifikisht, të ofrojë zgjidhje që janë në frymë të programit tonë politik që promovon drejtësi sociale, solidaritet shoqëror dhe shtet funksional. Shembull, prej këmbënguljes sonë parlamentare për ta aprovuar Ligjin për Pagat, kundërshtimit të projekteve të dëmshme si ky i "Contour Global" për termocentralin e ri, formulimit të strukturës negociatore në procesin me Serbinë e deri te angazhimi aktual për ta ngritur vlerën e pagës minimale, PSD-ja përpiqet që në skenë politike ta promovojë përkufizimin e politikëbërjes si angazhim për zgjidhje të problemeve, e jo vetëm të konstatimit të tyre.

**"Epoka e re":** Kritikat më të mëdha PSD-së i kanë ardhur nga dy subjektet opozitare, LDK-ja dhe LV-ja. Madje vazhdimisht ua përmendin edhe disa sondazhe, sipas të cilave, PSD-ja nuk del mirë. Pse ky agresivitet i opozitës ndaj një subjekti opozitar?

**Gorani:** Patjetër, burimi i këtyre kritikave ndërlihet me ngjarjet që i paraprinë strukturimit të sotëm të PSD-së. Largimi nga Lëvizja Vetëvendosje, themelimi i një grupi të pavarur të deputetëve dhe, tutje, përbashkimi i tyre për vazhdim të angazhimit përmes rimendimit të një subjekti politik, shkaktuan reagime kritike në opinionin

publik, përfshirë këtu edhe këto parti aktualisht opozitare. Jo rrallëherë këto reagime ishin panevojshëm të ashpra, të shkaktuara nga moskuptimi i kontekstit politik dhe, veçanërisht, nga keqinterpretimi i përpjekjeve tona që në politikë të insistojmë në efikasitet të veprimit, e jo vetëm në performancë kundërshtuese dhe opozitarizëm formal. PSD-ja është subjekt opozitar. Mirëpo, të jesh opozitë nuk nënkupton vetëm kundërshtim. Shkathtësi opozitare është ta gësh mënyrën që ta detyrosh pushtetin që t'i pranojë dhe t'i

zbatojë iniciativat e tua programore e shoqërore. Mendoj se kundërshtimi rutinor i një pushteti të ditës, pa ndonjë program apo qëllim, paraqet një formë të konformizmit politik: një qasje e tillë është reaktive dhe pasivizuese meqë nuk të detyron në angazhim dhe kreativitet të mendimit dhe të veprimit. PSD-ja përpiqet të promovojë opozitarizëm aktiv, duke imponuar agjendën e vet partiake përmes komunikimit dhe bashkëpunimit, e jo vetëm përmes mospjesëmarrjes dhe refuzimit.

Mendoj se në vitet e fundit është shtrembëruar tej mase definicioni i opozitarizmit, duke u reduktuar vetëm në gatishmëri për konfrontime grupore dhe përplasje personale. Kjo nuk po i ndihmon debatit racional shoqëror meqë po e mirëmban përshtypjen se politika shtetërore s'është tjetër veçse fushëbetejë morale mes 'të mirëve' dhe 'të këqijve'. Një qasje e tillë po e vazhdon iluzionin se një pushtet i ditës na qenka i imponuar dhunshëm, e jo i zgjedhur me votë. Sado e pakëndshme, e vërteta aritmetike është se

## Beqaj: Përfshirja e ShBA-së, e pashmangshme për t'i zgjidhur kontestet në Ballkan

UASHINGTON, 9 MAJ (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, po qëndron në Uashington, ku po merr pjesë në tryezën e diskutimit me kongresmenë dhe personalitete të tjera me ndikim në skenën politike. Beqaj gjatë fjalimit të tij ka

theksuar ndikimin gjeopolitik në zhvillimin e Ballkanit si dhe rëndësinë e vazhdimin të procesit të integritimit. "Përfshirja e ShBA-së është e pashmangshme për t'i zgjidhur kontestet në Ballkan dhe për të garantuar mirëqenie të qëndrueshme", ka thënë Beqaj.

Ministri Beqaj gjatë qëndrimit të tij në ShBA do të pritë në takim nga kongresmeni Robert Adelhort si dhe do të jetë folësi kryesor në konferencën "Smart Cities 2019", ku do të prezantohet shteti i Kosovës me financimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.



# shtë me dialogun Kosovë - Serbi



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

qeveritë tona fitojnë pushtetin përmes votës së qytetarit. Ky fakt nuk mund të zhbëhet vetëm me përsëritje të frazave mbi 'zaptimin e institucioneve' dhe 'kapjen e shtetit'. Pa dyshim, tradita e qeverisjes në Kosovë është ajo e korrupsionit, nepotizmit dhe klientelizmit, mirëpo kjo nuk zhbëhet dot vetëm përmes refuzimeve, vajtimeve e konfrontimeve. PSD-ja beson se vetëdija e përgjithshme shoqërore mund të avancohet edhe përmes zgjidhjeve adekuate qeverisëse. E ato duhet të imponohen vazhdimisht, pavarësisht asaj

nëse jeni në pushtet apo në opozitë. Vetëm kësajsoj, politika si përpjekje për të mirën e përgjithshme fiton kuptim.

**"Epoka e re":** Qeveria aktuale po i bënë dy vjet. Cili është vlerësim juaj për qeverisjen e PAN-it?

**Gorani:** Mendoj se qeverisja aktuale paraqet version paksa më të banalizuar të traditës së qeverisjeve të deritashme, të përqendruara në pushtetëzim dhe pasurim të një grupi të vetëm shoqëror që përkufizohet rajonalisht, historikisht dhe kulturalisht. Asgjë e re kjo, për

logjikën politike të pasluftës. Megjithatë, ndryshe prej koalicioneve të mëhershme qeverisëse, ky i sotmi është shumë më fragjil dhe më i varur nga përkrahja parlamentare. Kjo nënkupton se pjesa më e madhe e projekteve të dëmshme të tij mund të ndalohen relativisht lehtë përmes kundërshtimit parlamentar. Në anën tjetër, kjo mungesë e fuqisë për projekte ambicioze po e detyron që t'i shpërdorë skajshëm fushat e vetme që i kontrollojnë, si punësimet partiake në sektorin publik dhe malverizimet brenda tij.

Mirëpo, edhe kjo po shkakton përplasje të vazhdueshme mes numrit tepër të madh të partnerëve të koalicionit, andaj mbijetesa e tij është sfidë e përditshme. Sidoqoftë, sado jostabil përbrenda dhe konfliktos për së jashtmi, duket se fati i këtij koalicioni është i lidhur ngushtë me procesin politik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në fakt, vazhdimi i këtij procesi përbën edhe arsyen kryesore të formimit të tij, gati dy vjet më herët. Andaj, nuk duket të ketë ndonjë interesim real, as lokal e as ndërkombëtar për rrëzimin e tij. Kryesisht, opozita parapëlqen mundësinë që kjo qeveri të jetë ajo që e përmbyllë këtë proces, nga frika se rezultati i tij do të jetë i pakëndshëm për vendin. Në anën tjetër, qeveria përpiqet ta shohë të kundërtën: përmbyllja e procesit do t'ia mundësonte asaj rritjen e popullaritetit dhe, rrjedhimisht, vazhdimin e pushtetit. Në fakt, taktizimet e këtilla e sollën mbarë procesin në pikën ku ndodhet aktualisht: në paralizë të plotë, të brendshme dhe të jashtme. Pjesa më e madhe e opozitës i druan pjesëmarrjes në të, kurse pushteti i druan vendimmarrjes në të. Një situatë tipike për politikën kosovare.

**"Epoka e re":** Ju jeni një nga anëtarët e ekipit negociator për bisedime me Serbinë. A ka ndryshuar diçka ky proces nga Samiti i Berlinit dhe cilat janë pritjet e juaja nga Samiti i Parisit, ku do të diskutohet vetëm për këtë çështje?

**Gorani:** Samiti i Berlinit u përpjek ta ripromovojë një qasje sa tradicionale për Evropën Perëndimore aq edhe bashkëkohore për Ballkanin e helmuar me nacionalizëm etnik: atë se kufijtë e shteteve nuk janë domosdoshmërisht kufij të kombeve etnike. Aty kjo u shpalo edhe si formë e kundërshtimit ndaj përsiatjeve gjeopolitike të vitit të kaluar që përqendroheshin në botëkuptimin e 'zgjidhjes së thjeshtë' për 'problem të thjeshtë', e që nënkuptonte shkëmbim territorial për popullata me qëndrime dhe histori antagoniste. Tash diçka tjetër është se deri

në ç'masë synimet ambicioze të Samitit të Berlinit do të jenë të kuptueshme, të pranueshme dhe të zbatueshme brenda realiteteve politike e shoqërore të Kosovës dhe Serbisë. Kjo mbetet të shihet nga koha dhe mënyra se si do të rifillojë procesi i bisedimeve. Për aq sa po shoh, në këtë diskutim po mungojnë dy komponentët kryesorë që do ta mundësonin një përmbyllje të suksesshme: zotimi për njohje të shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë dhe ai për perspektivë zgjeruese evropiane për rajonin, nga ana e BE-së. Nuk shoh shumë arsye për vazhdim kuptimplotë të procesit pa demonstrim formal të këtyre zotimeve.

**"Epoka e re":** Nga Samiti i Berlinit u pa se Gjermania dhe Franca kanë marrë rol prijës në këtë proces. Po roli i ShBA-së, cili duhet të jetë?

**Gorani:** Edhe pse retorike, mendoj se kjo pyetje është e pavend. Roli i ShBA-së nuk mund të reduktohet e as të vendoset në kontekst të imagjinuar të një konfrontimi evropian. Mendoj se pohimet e këtilla burojnë nga mosnjohja e thellë e qasjeve ndërkombëtare karshi çështjes së Ballkanit. Sikurse BE-ja, ashtu edhe ShBA-ja, po përpiqen të gjejnë zgjidhje përmbyllëse për një problem politik në Ballkanin e cili po zgjat panevojshëm shumë, edhe pse me rëndësi tepër të vogël për botën. Ky proces duhet të përmbyllet patjetër meqë vazhdimi i ekzistimit të tij është i pakuptimtë dhe i paarsyetueshëm për botën e zhvilluar. Sipas tyre, duhet ndërprerë logjika e mirëmbajtjes së tensioneve etnike që prodhojnë qeverisje populiste, e të cilat, rrjedhimisht, plaçkitin shoqëritë e veta duke i dëmtuar ekonomikisht, kulturalisht dhe, madje, demografikisht. Çfarëdo zgjidhje që mund të arrihet përmes procesit negociator do të jetë e suksesshme vetëm nëse përkrahjet dhe mbështetjet nga instancat ndërkombëtare me fuqi vendimtare për rajonin. Këtu, roli i ShBA-së dhe i BE-së, është i pakontestueshëm.

## Dyqani "Medica Gjakova" ofron mundësi të ndryshme të fuqizimit ekonomik të grave

**GJAKOVË, 9 MAJ (ER)** - Ish-presidentja Atifete Jahjaga, së bashku me një delegacion me përfaqësues të "Stone Castle" dhe të mysafirëve të tyre, ka vizituar të enjten dyqanin "Medica Gjakova", për ta parë nga afër kapacitetin për prodhim dhe produktet e ndryshme të këtij dyqani. Jahjaga ka thënë se dyqani "Medica

Gjakova" ofron mundësi të ndryshme të fuqizimit ekonomik të grave, në veçanti të të mbijetuarave të dhunës seksuale, përmes shitjes së mjaltës, produkteve të qumështit dhe produkteve të ndryshme të freskëta dhe organike. "Duke blerë në dyqanin e tyre në Gjakovë përkrahim gratë drejtpërdrejt. Si

'Medica Gjakova' ka edhe shumë organizata që punojnë me të mbijetuarat të dhunës seksuale, të cilat janë prapa produkteve të freskëta dhe të shijshme, si dhe krijojnë çanta, bizhuteri dhe produkte të tjera të jashtëzakonshme. Duhet t'i përkrahim më shumë ato", ka thënë Jahjaga.



Kërkohet ndryshimi i Ligjit për festat zyrtare, por mungon iniciativa

## Kërkohet që Dita e Evropës të mos jetë festë zyrtare në Kosovë



Republika e Kosovës vazhdon ta ketë në kalendarin e festave zyrtare Ditën e Evropës, 9 Majin, ani pse një gjë e tillë kundërshtohet nga të gjithë. Madje edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës mendojnë se kjo datë nuk duhet të jetë ditë pushimi në Kosovë, por ende ata nuk kanë marrë ndonjë iniciativë për ta ndryshuar Ligjin për festat zyrtare. Sipas tyre, Kosova nuk ka asnjë arsye që këtë datë ta ketë në kalendarin e festave zyrtare

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 MAJ - Deputetët e Kuvendit të Kosovës edhe një herë kanë kërkuar heqjen e Ditës së Evropës nga kalendarin e festave zyrtare. Pavarësisht prej pretendimeve të tyre, ata ende nuk kanë marrë ndonjë iniciativë konkrete për ndryshimin e Ligjit për festat zyrtare në vend. Kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra, në Ditën e Evropës ka shkruar, në llogarinë e vet në "Facebook", se Kosova nuk ka asnjë arsye që ta festojë këtë

ditë. "Pse duhet të festojmë sot?! Nuk ka as edhe një arsye të vetme që Kosova ta festojë Ditën e Evropës. Madje është paradoksale të festohet sot, kur ditë pushimi nuk kanë as vendet anëtare të Bashkimit Evropian e jo më Kosova, shtet i cili nuk e ka as statusin e kandidatit në BE", ka thënë deputetja Deliu-Kodra, duke shtuar se kjo festë duhet të hiqet nga kalendarin e festave zyrtare. "Ligji për festat zyrtare duhet të trajtohet dhe të largohet 9 maji si festë zyrtare. Nuk bëhemi më proevropianë nëse sot festojmë. Përkundrazi, duhet të punohet shumë më

shumë për t'u afruar me shtetet e BE-së", ka theksuar Deliu-Kodra.

Edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka kundërshtuar një gjë të tillë. "Hipokrizi në Ditën e Evropës. Ne bëhemi sikur jemi shumë të gëzuar me këtë ditë, sa që bëhemi më Papë se Papa dhe, ndryshe, nga gjithë dynjaja, e bëjmë edhe ditë pushimi, ndërsa Bashkimi Evropian e ka në majë të gjuhës perspektivën evropiane të Kosovës, po ndryshe prej gjithë pjesës tjetër të kontinentit, veç qytetarët e saj ka lënë në

'Geto', ka shkruar Nitaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka vlerësuar se kjo datë vitin e ardhshëm nuk duhet të jetë ditë pushimi. "Për ta bërë një hap drejt BE-së, vitin tjetër, 9 majin e kishim shënuar në punë dhe në shkollë, duke punuar e duke mos dalë prej rrjedhave me ditë të panevojshme pushimi. Shtetet e BE-së e shënojnë këtë ditë, e ashtu duhet edhe ne", ka shkruar Murati në llogarinë e vet në "Facebook".

Blerim Latifi, këshilltar i kryeparlamentarit Kadri Veseli, ka treguar se si Dita e Evropës ka mbetur festë zyrtare. Ai ka thënë se Dita e Evropës në festë zyrtare është produkt i kohës së shpalljes së pavarësisë, e cila ishte kohë e euforisë, entuzi-

azmit dhe naivititetit.

"Shndërrimi i Ditës së Evropës në ditë feste zyrtare në Kosovë është produkt i kohës së shpalljes së pavarësisë. Ajo ishte kohë e euforisë, entuziazmit dhe naivititetit. Me naivitet besonim se, meqë Kosova ishte bërë shtet, tani çdo gjë do të shkonte mirë dhe shpejt, përfshirë edhe integritetin në BE. Prandaj, pse të mos festonim. Por, ajo që kalon më shpejt, është vetë euforia. Vendi e saj e zë zhgënjimi, i cili vjen për të na dhënë leksionin se gjërat e mira nuk bëhen lehtë dhe shpejt, dhe se politika, sa është art i zgjidhjes së problemeve të shoqërisë, po aq di të bëhet edhe art i krijimit të tyre", ka deklaruar Latifi.

Dita e Evropës është vetëm një nga njëmbëdhjetë festat zyrtare vjetore në Kosovë, sipas Ligjit për festat zyrtare, të cilat shënohen me ditë pushimi.

## Ambasadorja Geci-Sherifi dorëzoi kredencialet te Mbreti i Suedisë

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Ambasadorja e Republikës së Kosovës, Shkëndije Geci-Sherifi, i ka dorëzuar Letrat Kredenciale Mbretit të Suedisë, Lartmadhërisë së Tij Carl Gustaf XVI, nëpërmjet një ceremonie shtetërore e cila është zhvilluar në Pallatin Mbretëror Kungliga slottet në Stokholm. Me këtë rast, ambasadorja Geci-Sherifi i përcolli përshëndetjet e kreut shtetëror të Republikës së

Kosovës për Lartmadhërinë e Tij dhe për popullin suedez. Në vazhdim, ajo ka theksuar se marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Suedisë janë të shkëlqyera, duke shprehur mirënjohjen e thellë për përkrahjen që Suedia e ka dhënë për pavarësinë dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës. Ambasadorja Geci-Sherifi gjithashtu u zotua se do të kontribuojë maksimalisht për kultivimin dhe avancimin e

më tutjeshëm të raporteve në mes të dy vendeve mike në të gjitha fushat e interesit bilateral. Ky është mandati i tretë i ambasadores Geci-Sherifi, e cila më parë ka shërbyer si ambasadore e Republikës së Kosovës në Hungari dhe Kroaci, me ç'rast është dekoruar nga të dy presidentët e këtyre shteteve për punë të shkëlqyer për promovimin e marrëdhënieve dypalëshe.



# Në Ditën e Evropës bëhet thirrje për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës

Me rastin e Ditës së Evropës, përfaqësuesit e institucioneve të vendit kanë bërë thirrje të enjten për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës pasi, sipas tyre, populli ynë është më evropian se shumë popuj që janë pjesë e familjes evropiane

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Dita e Evropës është ditë ceremoniale, që shënohet më 9 maj të çdo viti nga Bashkimi Evropian (BE), në njohje të paqes, prosperitetit dhe unitetit të arritur brenda Evropës, që nga formimi i kësaj organizate. Në Republikën e Kosovës Dita e Evropës është festë zyrtare. Kjo ditë të enjten është shënuar me aktivitete të ndryshme. Përfaqësuesit e institucioneve të vendit kanë bërë thirrje për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës pasi, sipas tyre, populli ynë është më evropian se shumë popuj që janë pjesë e familjes evropiane. Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, e shoqëruar edhe nga shefja e re e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së, Nataliya Apostolova, kanë marrë pjesë të enjten në një aktivitet të organizuar për Ditën e Evropës. Ministrja Hoxha ka thënë se Dita e Evropës, 9 Maji, është ditë e veçantë për Bashkimin Evropian. "Duke synuar bashkimin me vlerat e këtij bashkimi, ne jemi më pro evropianë se shumë popuj që janë pjesë e familjes evropiane.

Ne i kemi përmbushur kriteret për liberalizim, por ende qytetarët tanë janë të privuar nga drejta e lëvizjes së lirë. Është koha që edhe qytetarët tanë të lëvizin të lirë sa më shpejt, por edhe Ditën e Evropës ta shënojmë duke punuar, e jo duke pushuar", ka thënë Hoxha.

**Thaçi: Qytetarët e Kosovës janë më evropianë se shumë popuj që janë pjesë e familjes evropiane**

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Dita e Evropës, 9 Maji, është datë kur u bë hapi i parë drejt krijimit të Bashkimit Evropian. "Një thirrje për bashkimin e prodhimeve nga kryediplomati francez më 9 maj 1950, kishte bërë që të niste projekti i madh i krijimit të familjes evropiane, e cila u zhvillua nëpër vite. Në këtë ditë të veçantë për Bashkimin Evropian, ne bëjmë thirrje për liberalizimin e vizave për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe për qartësimin e perspektivës evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor", është shprehur Thaçi.

Ai ka thënë se qytetarët e Kosovës janë më evropianë se shumë



popuj që janë pjesë e familjes evropiane. "Kemi përmbushur kriteret që tejkalojnë edhe standardet e shumë prej shteteve anëtare të BE-së, por ende po vazhdon diskriminimi i qytetarëve tanë. Ky diskriminim dhe ky trajtim i pabarabartë po komprometon edhe vetë vlerat e Bashkimit Evropian mbi të cilat e ka ndërtuar bashkëpunimin me vendet jo anëtare në rajonin tonë. Bashkimi Evropian duhet t'i japë fund izolimit të qytetarëve të Kosovës!", ka deklaruar presidenti Thaçi.

**Veseli: Kosova ka përmbushur detyrat e saj për liberalizimin e vizave**

Kosova ka vetëm një vizion dhe ndjek vetëm një rrugë: Integrimin në botën perëndimore. Kështu ka thënë kryetari i Kuvendit të

Kosovës, Kadri Veseli, me rastin e Ditës së Evropës. Veseli ka thënë se Kosova ka përmbushur detyrat për liberalizimin e vizave. "Kjo është një e drejtë historike e popullit tonë, që jo vetëm gjeografikisht, por edhe në vlera dhe identitetin i përket kësaj bote. Kosova beson dhe punon në këtë drejtim. As sfidat që sot kemi, e as hezitimet e institucioneve të BE-së nuk do të mund të na ndalin në të drejtën tonë legjitime. Kosova ka përmbushur detyrat për liberalizimin e vizave. BE-ja duhet t'u përmbahet obligimeve dhe premtimeve të veta. Izolimi i padrejtë i qytetarëve të Kosovës nga liria e lëvizjes në BE, sot në Ditën e Evropës, është një njollë për BE-në", ka theksuar Veseli.

**Haradinaj: Urime Evropë, Kosova është e jotja!**

Kryeministri Ramush Haradinaj

ka theksuar se Kosova shënon Ditën e Evropës sot sepse është pjesë gjeografike, ideologjike dhe identitare e familjes evropiane ndër shekuj. Ai ka thënë se qytetarët dhe institucionet e Kosovës sot kanë aspiratë të vetme integrimin e plotë në Bashkimin Evropian. "Në shënimin e Ditës së Evropës këtë vit, Kosova zotohet fuqishëm për ta vazhduar përkushtimin e pandalshëm për integrim në BE dhe për mbrojtje të vlerave demokratike të cilat na bashkojnë. Po sot u bëjmë thirrje shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të BE-së, që t'i njohin dhe pranojnë të arriturat e Kosovës dhe të mos vazhdojnë të mbajnë qytetarët e Kosovës edhe më tutje padrejtësisht të izoluar nga familja që i takojnë. Urime Evropë, Kosova është e jotja!", ka pohuar Haradinaj.



## RDK-ja shpreh shqetësim në Ditën e Evropës për lëvizjen e lirë

Rinia Demokratike e Kosovës (RDK) në mënyrë simbolike ka shënuar të enjten Ditën e Evropës, 9 Majin. Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës, Donjet Bislimi, ka bërë me dije se me këtë aktivitet ngrehën shqetësimin drejtuar Bashkimit Evropian dhe vendeve evropiane, pasi edhe pse janë përmbushur kërkesat për lëvizje të lirë, Kosova po vazhdon të mbetet e izoluar. "Me improvizimin e disa simboleve evropiane

rreth simbolit tonë, shenjtores Nëna Terezë, duam të tregojmë se ne jemi pjesë e Evropës dhe jemi në zemër të saj, me vlerat universale që përcolli shenjtorja Nëna Terezë. Me vlerat dhe parimet tona tradicionale, ne ia shtojmë vlerat BE-së dhe e pasurojmë diversitetin e mrekullueshëm kulturor evropian, por përqafojmë vizionin e përbashkët për paqe dhe prosperitet", ka thënë ai. Bislimi ka pohuar se rinia e

Kosovës ka potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe talent. "Nuk dallon nga bashkëmoshatarët evropianë, bile në raste të ndryshme mund të jetë edhe më e avancuar, andaj kërkojmë që mos të na mohohen të drejtat thelbësore për lëvizje, socializim dhe shkëmbim të përvojave dhe ideve për një Evropë dhe botë më të mirë, me bashkëmoshatarët tanë në BE", është shprehur Donjet Bislimi.

## Banka "ProCredit" përkrah iniciativën e ministrit Lluka për fuqizimin e makinave elektrike

Prishtinë, 9 maj (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të enjten në takim kryeshëfën ekzekutive të bankës "ProCredit" në Kosovë, Eriola Bibolli, e cila e ka informuar që pronarët e bankës e kanë aprovuar financimin për një investim të

ri në energji solare deri në 3 MW, si politikë e bankës për ta përkrahur energjinë e ripërtëritshme në Kosovë dhe botë. Sipas ministrit Lluka, banka "ProCredit" ka shprehur gatishmërinë për ta përkrahur iniciativën e tij për fuqizimin e makinave elek-


trike, duke ofruar kushte më të mira të financimit si dhe duke instaluar mbushës për makina elektrike në vende të ndryshme. "Më bën të lumtur fakti që energjia alternative dhe eficienta e energjisë po përkrahen nga të gjithë", ka thënë Lluka.



Është mbajtur akademi përkujtimore në 21-vjetorin e rënies së heronjve të Kosovës, gjeneralmajor Ilir Konushevcin dhe dr. Hazir Malaj

# Haradinaj: UÇK-ja i ka pasur të rrallë heronjtë si Konushevcin e Malajn

"Falë Ilir Konushevcit ka ndodhur pranvera më e fuqishme e luftës shqiptare ndonjëherë, duke hyrë mijëra e mijëra armë në Kosovë. Nuk ka dilemë që çdo brez i patriotëve e i luftëtarëve shqiptarë, dijetarëve e atdhetarëve, i ka heronjtë e vet dhe se brezi i UÇK-së i ka pasur të rrallë heronjtë si Ilirin dhe Hazirin", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë përkujtimore mbajtur me rastin e 21-vjetorit të rënies së heronjve të Kosovës, Ilir Konushevcin dhe dr. Hazir Malaj

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 MAJ - Të enjten është mbajtur akademi përkujtimore në 21-vjetorin e rënies së heronjve të Kosovës, gjeneralmajor Ilir Konushevcin dhe dr. Hazir Malaj. "Jemi bashkuar sot plot familje të dëshmorëve e të heronjve të kombit, bashkëluftarë të gjallë, në këtë ditë të dhimbjes tonë, por edhe e porosis së gjallë, se për të drejtën tonë, për atdheun, shqiptarët çdoherë do të jenë bashkë, do të flijohen bashkë dhe qëndrojnë bashkë", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë përkujtimore mbajtur me rastin e 21-vjetorit të rënies së heronjve të Kosovës, Ilir

Konushevcin dhe dr. Hazir Malaj, e cila është organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit.

Para familjarëve të dëshmorëve, heronjve, bashkëluftarëve të gjallë të tyre, gjeneralë, zyrtarë shtetërorë, kryeministri Haradinaj ka theksuar se sot kujtojnë një ditë më ndryshe dhe është më ndryshe për shumë arsye pasi, Ilir Konushevcin, siç thaj ai, ishte ndër luftëtarët shumë të ri, duke qëlluar në atë rrethin e parë të ngushtë me heronjtë e kombit, Zahirin e të tjerët. "Pra, ishte ndër të parët, në veprimet e para, njësitë e para me themeluesit e UÇK-së. Kjo është një vlerë që duhet ta veçojmë, pasi bëhet fjalë për brezin e parë të luftëtarëve të UÇK-së dhe atyre që i

vendosën themelet e luftës për liri. Kjo është një dëshmi e vërtetë. Ai, po ashtu, ishte ndër të parët që bashkëveproi me të gjitha njësitë e para të UÇK-së në zonat e tjera duke vendosur lidhje komunikimi dhe bashkëveprimi jo vetëm funksional, por edhe luftarak dhe veprues", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se rritja e UÇK-së dhe përballja në luftë ishte një kapërcim i madh shumë i vështirë sepse, përpos që nevojiteshin njerëz të vendosur për luftë, nevojiteshin edhe teknikë luftarake pa të cilën ishte e pamundshme ballafaqimi me pushtuesin.

Kujtimin e asaj periudhe kryeministri Haradinaj e përshkroi si një moment kur të gjithë ata ishin të fokusuar në ndërtimin e luftëtarit që nënkuptonte kompletimin luftarak, qëndrimin me dinjitet përballë armikut. "Ata e donin veç një pushkë dhe Iliri e mori pjesën më të vështirë duke lënë zonën e bashkëluftëtarëve të vet që të siguronin teknike luftarake për zonat më afër përbaljes frontale, siç ishte edhe zona e Dukagjinit", ka thënë Haradinaj, duke sqaruar edhe lidhjen me Hazir Malajn dhe rolin e tij të rëndësishëm në atë kohë lufte.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se atëkohë kishin nevojë për njerëz të besueshëm për bartjen e teknikës ushtarake, duke thënë se ishin pikërisht ato familje, si familja e Hazir Malajt, që shprehën devotshmërinë sublime për lirinë e vëllezërve dhe motrave kosovare. "Falë Ilir Konushevcit ka ndodhur pranvera më e fuqishme e luftës shqiptare ndonjëherë, duke hyrë mijëra e mijëra armë në Kosovë", ka theksuar kryeministri Haradinaj, duke thënë se rënia e Ilir Konushevcit nuk është një befasi, pasi një mision të tillë armiku nuk ka mundur ta përballojë ndryshe. Në fund të fjalës së tij, kryeministri Haradinaj shtoi se nuk ka dilemë që çdo brez i patriotëve e i luftëtarëve shqiptarë, dijetarëve e atdhetarëve, i ka heronjtë e vet dhe se brezi i UÇK-së i ka pasur të rrallë heronjtë si Ilirin e Hazirin. Në këtë ceremoni nga një fjalë mbajtën gjeneral Kudosin Lamë, ish-komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ndërsa në emër të bashkëluftarëve foli Lahi Brahimaj, i cili evokoi kujtime nga lufta e UÇK-së. Përmes një kumtese tematike, prof. Skender Zhitia shpallosi punën, veprimtarinë dhe rëndës-

inë e heroit të Kosovës, gjeneralmajor Ilir Konushevcit, për organizimin e luftës së UÇK-së dhe për kontributin e dr. Hazir Malajt, ndërsa në emër të familjeve të heronjve, të pranishmit i përshëndeti Arton Konushevcin, vëllai i heroit Ilir Konushevcin.

Heroin Ilir Konushevcin e ka përkujtuar presidenti Hashim Thaçi, i cili, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se para 21 vjetëve Ushtria Çlirimtare e Kosovës humbi njërin nga kuadrot më të shquara, Ilir Konushevcin. "Ilir Konushevcin, hero i Kosovës, ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për forcimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka shkruar Thaçi. Po ashtu, edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në 21-vjetorin e rënies së Ilir Konushevcit ka thënë se koha nuk mund t'i zbehë kujtimet për dëshmorët e kombit. "Vitet kalojnë, por kujtimin për dëshmorët e kombit koha nuk mund ta zbehë. I tillë është dhe do të mbetet gjithmonë kujtimi dhe nderimi për heronin e lirisë, Ilir Konushevcin", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se më 9 maj bëhen 21 vjet nga rënia heroike e njërit prej luftëtarëve të orëve të para për lirinë e Kosovës, strategut të madh të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, heroit të kombit Ilir Konushevcin. Ai ka thënë se gjeneral Ilir Konushevcin do të mbetet përherë në kujtesën tonë si një atdhetar i pashoq e luftëtar i paepur për lirinë e Kosovës. "Po këtë ditë kujtojmë edhe mjekun nga Tropoja, dëshmorin e kombit dr. Hazir Malaj. Lavdi jetës dhe veprës së Ilir Konushevcit dhe Hazir Malajt! Lavdi dëshmorëve të kombit!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Haradinaj pret në takim familjen e Ilir Konushevcit dhe të Hazir Malajt

Në 21-vjetorin e rënies së gjeneralmajor Ilir Konushevcit dhe dr. Hazir Malaj, kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në zyrën e vet familjet e dy heronjve të Kosovës. "Së bashku evokuam kujtime për rrugën tonë deri në liri dhe sakrificat e mëdha të popullit shqiptar. Si Iliri e Haziri, shqiptarët, të bashkuar, përjetë do të jenë në mbrojtje të të drejtës së tyre", ka thënë Haradinaj pas takimit.





# Vdekjet dhe lëndimet në vendin e punës, shqetësuese, pezullohen mbi 100 vendpunishte



Situata e krijuar në sektorin e ndërtimit të lartë, me një numër të madh të lëndimeve e, fatkeqësisht, edhe të vdekjeve në vendin e punës, përbën shqetësim për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizatat që mbrojnë të drejtat e punëtorëve. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije se u është pezulluar puna mbi 100 vendpunishteve të cilat nuk kanë respektuar masat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë

Kuvend. Krahas këtyre ndryshimeve ligjore, në vitin e kaluar, bashkë me Inspektoratin e Punës, ndërmorëm një aksion që konsistoi me shtimin e inspektiveve në sektorin e ndërtimit të lartë, aty ku numri i aksidenteve dhe lëndimeve është më i madh", ka thënë Reçica.

Ai ka theksuar se në kuadër të këtij plani në nëntor të vitit të kaluar zbarkuan në Prishtinë pothuajse tërë kontingjentin e inspektorëve, me qëllim të sigurimit për respektim të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, të përcaktuara me legjislacionin aktual. "Gjatë këtij aksioni u është pezulluar puna mbi 100 vendpunishteve të cilat nuk kanë respektuar masat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe brenda një kohe të shkurtër, shumica prej tyre kanë arritur t'i plotësojnë masat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ky aksion që ne e kemi ndërmarrë ka bërë që në sektorin e ndërtimit në Prishtinë të ndërrojnë pamja dhe pothuajse në secilën vendpunishte të respektohen masat për siguri dhe shëndet në punë. Ky aksion ka vazhduar dhe është duke u realizuar edhe në komuna

të tjera", është shprehur ministri Reçica.

Ai ka shtuar se krahas këtij aksioni, edhe vitin e kaluar dhe para pak ditësh kanë lansuar fushata vetëdijësuese me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për respektim të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë. "E kam potencuar disa herë dhe po e theksoj edhe tani, do të jemi të pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat e sigurisë dhe të shëndetit të përcaktuara me ligjet në fuqi, andaj ftoj punëdhënësit, ashtu edhe punëmarrësit, t'i respektojnë këto masa në mënyrë që t'i shmangim lëndimet dhe vdekjet në vendin e punës", është shprehur Skender Reçica, ministër Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve, 1 Majit, kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Avni Ajdini, ka kërkuar nga institucionet rritje të sigurisë dhe sigurimit shëndetësor në punë. Ndërkaq, nënkryetari i Sindikatës së Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nexhat Llumnica, ka thënë se punëtorët po vdesin çdo ditë duke mos guxuar ta

ngrehin zërin për padrejtësitë që u bëhen. "Çdo ditë punëtorët lëndohen, madje edhe vdesin në vendin e punës. Nuk po flasim për kontratat e tyre të punës, sepse ato nuk ekzistojnë, sidomos në sektorin privat. Jam i bindur se ata nuk guxojnë as t'i shprehin pakënaqësitë, sepse ky shtet është kapur nga politika dhe partitë politike", ka thënë Llumnica.

Lidhur me shkeljet e të drejtave të punëtorëve, ditët e fundit Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur një tryezë diskutimi, në të cilën ka prezantuar raportin "Të drejtat në letër". Konkurse të manipuluar, procedura gjyqësore të papërfunduara që lidhen me punën, punë 24 orë pa ndërprerë, mospagesë të kontributeve pensionale nga punëdhënësi, mospagesë të pagave deri në 8 muaj, privim nga pushimi vjetor dhe ai mjekësor, mospagesë për punën jashtë orarit të rregullt etj., janë disa prej shumë padrejtësive dhe shkeljeve me të cilat përballen punëtorët në Kosovë. Vetëm në katër muajt e parë të këtij viti katër punëtorë kanë humbur jetën dhe mbi 25 të tjerë kanë pësuar lëndime në vendet e tyre të punës.

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se situata e krijuar në sektorin e ndërtimit të lartë, me një numër të madh të lëndimeve e, fatkeqësisht, edhe të vdekjeve në vendin e punës, përbën shqetësim për ministrin që drejton. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se MPMS-ja përball kësaj situatë nuk ka qëndruar duarkryq. "Me përgjegjësi të plotë them se nuk kemi qëndruar duarkryq përballë kësaj situatë. Kemi shtuar përprjekjet

për rritje të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës nëpërmjet ndërmarrjes së një sërë veprimesh konkrete. Ndër veprimet e para ka qenë krijimi i një baze të re ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, nëpërmjet transpozimit të një sërë direktivave të BE-së, nëpërmjet hartimit të Projektligjit të ri të punës i cili është shqyrtuar në lexim të parë në Kuvend, hartimit të Projektligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror, si dhe plotësimndryshimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës, i cili ka kaluar në lexim të parë në

## 100 fermerë të rinj nga Gjilani dhe Kumanova trajnohen në ndërmarrësi

**GJILAN, 9 MAJ (ER)** - Në kuadër të projektit për bashkëpunim ndërkufitar "Tregu i qëndrueshëm për produkte të freskëta të fermerëve në zonën ndërkufitare të Komunës së Gjilanit dhe Kumanovës", i financuar nga Bashkimi Evropian, të enjten kanë filluar trajnimet treditore për 100 pjesëmarrës nga dy komunat

partnere. Menaxheri i këtij projekti, Eroll Januzi, ka thënë se nga fillimi në këtë projekt kishte një interesim të jashtëzakonshëm nga të rinjtë. "Interesimi i të rinjve për trajnimet në ndërmarrësi është i jashtëzakonshëm. 100 të rinj dhe fermerë aktivë nga Gjilani dhe Kumanova po trajnohen në

ndërmarrësi. Programi ka për qëllim që t'i bashkojë interesat e dy palëve për realizimin dhe ndërtimin e një tregu të vogël të përbashkët, duke u organizuar dhe trajnuar të rinjtë në ndërmarrësi, por edhe duke ndërtuar kapacitete të përbashkëta edhe për shkëmbimin e mallrave", ka thënë Januzi.



## Zbulohet monumenti që i dedikohet ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë

PRISHTINË, 9 MAJ - Ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku, ka thënë se ishte nderuar që bashkë me komandantin e Forcave Ajrore Amerikane, gjeneralin Goldfein, në ambientet e Departamentit Amerikan të

Mbrojtjes (Pentagon) zbuluan monumentin i cili i dedikohet ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë. "Gjenerali Goldfein edhe personalisht ka qenë pjesëmarrës në fushatën ajrore kundër çaqeve të regjimit të Millosheviqit. Më 2 maj '99 aeroplani ushtarak me të cilin

po fluturonte gjenerali Goldfein ishte goditur nga forcat serbe. Fatmirësisht, pas një operacioni të shpëtimit, gjenerali Goldfein ishte kthyer shëndosh e mirë në bazën ajrore të NATO-s në Itali", ka shkruar Çitaku në llogarinë e saj në "Facebook".



## Hapet pavijoni i Kosovës në Bienalen e Venedikut, marrin pjesë Veseli e Gashi

ynë ende ka shumë plagë të hapura, ku mijëra persona u vranë e u zhdukën, ndërsa kriminelët serbë të këtyre vrasjeve janë ende të lirë. "Zëri i Kosovës për të kërkuar drejtësi sot u paraqit edhe në Pavijonin e Kosovës në Bienalen e Venedikut, nëpërmjet paraqitjes së artistit tonë Alban Muja dhe komisionares Arta Agani", ka thënë Veseli

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se në prag të 20-vjetorit të çlirimit, shteti



Bienalen e Venedikut nëpërmjet paraqitjes së artistit tonë Alban Muja dhe komisionares Arta Agani. Në rrugën tonë të pakthyeshme për të kërkuar drejtësi për viktimat e luftës, një ndihmë të jashtëzakon-

shme do ta japin edhe Ministria e Kulturës dhe artistët nëpërmjet paraqitjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit", ka thënë Veseli.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë

se Kosova në Bienalen e Venedikut paraqitet në mënyrë dinjitoze. "Sot bashkë me kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, morëm pjesë në ceremoninë e hapjes së pavijonit të Kosovës në Bienalen e Venedikut, bashkë me artistin Alban Muja, komisionaren Arta Agani dhe ekipin tonë i cili ka bërë punë të jashtëzakonshme që sot vendi ynë të paraqitet në mënyrë dinjitoze në një prej ngjarjeve më të mëdha kulturore. Jam shumë i lumtur që Kosova artistët i ka ambasadorët më të mirë, të cilët po e promovojnë shtetin tonë gjithandëj botës. Si ministër jam në mbështetje të plotë të artistëve tanë dhe projekteve kulturore të cilat tashmë janë të pranishme në shumë ngjarje me renome botërore", ka thënë ministri Gashi.

PRISHTINË, 9 MAJ (ER) - Të enjten është hapur pavijoni i Kosovës në Bienalen e Venedikut. Pjesë e ceremonisë së hapjes së pavijonit të Kosovës në Bienalen e Venedikut, bashkë me artistin Alban Muja, komisionaren Arta Agani, ishin edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim

Gashi.

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se në prag të 20-vjetorit të çlirimit shteti ynë ende ka shumë plagë të hapura ku mijëra persona u vranë e u zhdukën, ndërsa kriminelët serbë të këtyre vrasjeve janë ende të lirë. "Zëri i Kosovës për të kërkuar drejtësi sot u paraqit edhe në Pavijonin e Kosovës në

## Slovakia mbështet çeljen e negociatave të Shqipërisë me BE-në

TIRANË, 9 MAJ - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, zhvilloi një vizitë zyrtare në Bratislavë, ku u prit nga ministri i Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës Sllovahe, Miroslav Lajčák. Takimi i zhvilluar pati në fokus marrëdhëniet dypalëshe, integrimin në BE, bashkëpunimin në kuadër të OSBE-së dhe bashkëpunimin rajonal.



Gjatë këtij takimi u vlerësuan marrëdhëniet miqësore mes dy vendeve, sikurse u konstatua se ka ende mundësi të paeksploruar

për ta fuqizuar bashkëpunimin ekonomik përmes miratimit të kuartrit ligjor dhe organizimit të takimit të parë të komisionit të përbashkët ekonomik me qëllim evidentimin e fushave me interes të përbashkët, si infrastruktura, energjia, hekurudhat, bujqësia dhe menaxhimi i ujërave.

Ministri Cakaj rikonfirmoi angazhimin e qeverisë shqiptare

për të kontribuar në vijimësinë e realizimit të objektivave kryesore të organizatës në vitin 2020, për të cilën mori edhe gatishmërinë e ministrit Lajčák për ofrimin përvojës dhe ekspertizës sllovahe si kryesuese aktuale e OSBE-së.

Për sa i përket procesit të integritimit evropian, ministri Lajčák u shpreh se Sllovakia mbetet avokate e fortë e procesit të zgjerimit dhe integritimit

të Shqipërisë në BE, duke e konsideruar Ballkanin Perëndimor të rëndësishëm për sa i përket adresimit të disa prej sfidave me të cilat përballet sot BE-ja.

Ministri në detyrë Cakaj e njoftoi homologun me përparimin e Shqipërisë në procesin e reformave dhe pesë prioritetet kyçe dhe pritshmërinë për një vendim pozitiv në muajin qershor.

## Basha: Të gjithë bashkë më 11 maj për Shqipërinë si Evropa

TIRANË, 9 MAJ - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, është pritur me ovacione dhe duartrokitje, si dhe nën thirrjet "Rama ik" në takimin të enjten padite në qytetin e Gjirokastrës, ku ishin mbledhur kryetarë dhe anëtarë të degëve të kësaj partie në qarkun jugor. "Ju falënderoj për këtë pritje kaq madhështore, nga shumë të rinj e të reja me në duar simbolet e Partisë Demokratike, flamujt e Shqipërisë, Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Sot është 9 Maji,

Dita e Evropës, e nga Gjirokastra, kjo energji frymëzuese për kauzën tonë të drejtë e të madhe i thotë çdo shqiptari e shqiptareje, pavarësisht prej bindjeve, moshës, krahinës, se ky komb është i bashkuar dhe i vendosur për Shqipërinë, si gjithë Evropa", tha Basha.


Sipas kreut të opozitës, me këtë thirrje nisi lëvizja studentore e dhjetorit të '90-s, me këtë u themelua Partia Demokratike dhe me këtë vijohet ende të luftohet sot për të shijuar pakëz

Evropë, në një rrugëtim plot sakrifica.

Pikërisht për shkak të masivitetit të mbledhjes së Gjirokastrës, Basha iu bëri thirrje të pranishmëve, por edhe të gjithë shqiptarëve, që të bashkohen të gjithë në protestën e 11 majit në Tiranë. "I duam shqiptarët me mirëqenie, ekonomi dhe të ardhme pikërisht këtu në Shqipëri. Të mos ikim më klandestinë, por ta ndërtojmë Evropën këtu te ne", tha Basha, duke këmbëngulur se gjithçka nis nga vota e lirë.



# Kënga e mjellmës e mashtruesve nga Brukseli, Beogradi, Prishtina dhe Tirana



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

**U lëshuan brekushet, askund nuk duken koçushet:** Thuaja që një vit pjesa dërrmuese e qytetarëve të Kosovës, hiç këtu disa të kotillës së Hashimit e që në të njëjtën kohë ishin kondomë të Edit dhe Acës, pamëshirshëm na dhunuan në mënyrën më të paskrupullt dhe të pandershme me lojën e korrigjimit të rëndë apo të lehtë të kufijve, këmbimit të territoreve, anshlusit të Luginës së Preshevës apo, së fundi, për ta shpëtuar dhe shpëlarë blozën nga pafytyra, po flitet për demarkacionin e kufirit me Serbinë, mall që e ha pazari për faktin se ndodhë midis të gjitha shteteve fqinje. Sikur edhe për taksën 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Dodikut, ku pati shumë ngjizës të deklaruar e të cilët pastaj e mohuan atësinë, edhe për këtë çoroditje territoriale ishin shumë të deklaruar, Hashimi, i pari, Kuraci i Austrisë, Makaroni i Francës, mashtruesja Mogerini nga Brukseli, rrugaçi Han nga Beogradi dhe disa burokratë nga Uashingtoni, Brukseli dhe qendra të tjera. Çuditërisht, i biri i Fahriut, e të cilin Ramushi e quajti bastard, u përmbajt deri në fund duke e fshehur autorësinë. Ai e kishte një formulim se: "Serbia duhet të fitojë diçka nëse ndërkombëtarët duan një kompromis me Prishtinën..." ndërsa, pas Berlinit, si Papë Françesku që i drejtohet masës në Sheshin e "Shën Pjetrit" në Vatikan, "urbi et orbi", ai iu drejtua të gjithë serbëve, Sheshelit, Daçiqit, Vulinit, Marko Gjuriqit, Legias,

së vesë së Arkanit, Dodikut, Johanes Hanit, Frederiçka Mogerinit, Radoiçiqit, Veselinoviçit dhe serbëve të tjerë të përkushtuar për paqe, deri në asgjësimin e shqiptarit të fundit. Realisht, në Kosovë dhunuesi numër një ishte presidenti Hashim i cili, 24 orë na ka terrorizuar dhe torturuar me lojën e kufijve, së bashku me sekserët politikë, njerëzorë, moralë, "kombëtarë" e, sidomos, të biznesit, gazetarë, prostituta politike dhe mediatike, patriotë të Turkmenistanit dhe hajvanë të Kazakistanit. Ka te Hashimi politikanë prej "kariere" që i kanë denoncuar shokët e ilegales duke i futur në burg, të tillë që baballarët e tyre ua kanë futur zhegrën (shufër metalike e zgjedhës së buajve) në prapnicë ish të burgosurve politikë e sot janë përcaktues të politikave të larta "shtetërore" apo njerëz shumë të besueshëm të presidentit. Mos të flasim për gjerdanin e bijve dhe bijave të baballarëve dhe majkave që më besnikërisht se qeni i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë, duke dhunuar çdo gjë shqiptare. Edi Rama ka luajtur një rol prej dyfytëreshi; në njërin anë, me një retorikë patriotike na ka futur zhegrën në tru kurse, në anën tjetër, me Acën dhe Hashimin na ka futur qepën në prapnicë! Po të mos ishte taksa 100 për qind, sot, Zhivadini dhe Millojka do të pshurrnin në liqenin e Ujmanit sikur që në shtëpinë time në Besianë do të hynte ndonjë Millan, Stojan apo Dragan. Po ky Dragan, dhëndër i Llapit, ka vdekur por, pasardhësit e tij, mund të pretendonin të hyjnë brenda dhe të bëhen fqinj me miqtë "shqiptarë" që nuk janë shumë larg shtëpisë sime! Frau Merkel i la pa top Hashimin dhe Acën, duke e kundërshtuar tregtinë me territore ku shqiptarët gjithmonë janë ndarë të humbur! Personaliteti shumë negativ në këtë prostitucion politik ishte dhe është, pa asnjë dyshim, Edi Rama, hamshori impotent. E tash, merreni me mend, i erdhi radha edhe Sali

Berishës ta improvizojë një kolazh patriotik, ku veten e vendos në qendër të këtij improvizimi. Çfarë degradimi njerëzor, moral, politik dhe kombëtar! Federiçka Mogerini, ende po vërdallet dhe gërvallet duke bërë përpjekjet e fundit ta luajë seksin politik dhe territorial me Acën dhe Hashën kurse, qirimajtës është spekulanti nga Vjena, Johanes Hani (mos mendoni se ka lindur në Velehtë të Strugës, më shumë ka të ngjarë të ketë lindur në Pozharevc të Sllobodan Millosheviçit). Dështoi në Berlin, por mund të shkëlqejë në Tiranë, ku Rama dhe Hashimi janë mysafirë, kurse Aleksandar Vuçiçi dhe burri i fortë i Serbisë Bernabiq sillen sikur të jenë zot të shtëpisë. Mogerini dhe Han janë mashtrues të pamoralshëm që, për karriera të tyre, e gjymtojnë Kosovën sikur që e zgjerojnë Serbinë së cilës i kanë shërbyer besnikërisht.

**Kameleonizmi politik dhe moral:** Hashim Thaçi po e mbron taksën 100 për qind më shumë se vetë Ramushi, vetëm sa nuk e ka bërë një uniformë ushtarake me mbishkrim: "në mbrojtje të taksës, deri në vdekje (sigurisht të Ramushit)...". Si fanatik i Mao ce Dunit nuk heq dorë nga Lugina e Preshevës dhe si një kursimtar çifut, nuk e jep edhe as një centimetër tokë të Kosovës, Serbisë. Burrërisht pati deklaruar se Asociacioni i Komunave Serbe (i Serbisë) në Kosovë është një OJQ e cila, për shkak të orientimit euroatlantik të Kosovës, qenka dashur të regjistrohet në Bruksel! Sikur që janë regjistruar edhe 20 000 OJQ-të të tjera që veprojnë dhe shumica e tyre kriminalizojnë në Kosovë! Tash Hashimi nuk shkon as te Dodiku në Bosnje për shkaqe parimore! Me kalimin e kohës Hashimi do të bëjë lëvizje që do t'i lë në hije Hasan Prishtinën, Shaban Polluzhën, Gjon Serreqin, Marie Shllakun, Shkurte Pal Vatën, Tahir Mehën, Rexhep Malën, Fehmi Lladrovcin,

Adem Jasharin dhe Adem Demaçin. Mirëpo, ka krijuar shoqëri të re patriotike me Vllasin, Begj Pacollin, Shpendkeqin, pasardhësit e Ali Shukrisë dhe të Mehmet Qorrit, Fadilit dhe Sinanit, Vukut dhe Draganit dhe shumë patriotë të tjerë. Unë i ruaj dyshimet e mia përkundër respektit të madh që e kam për të, por edhe nëse unë shkruaj mirë për të, është punë koti; kemi rënë në krizë të thellë të lëkundjes së besimit, ndonëse i besoj 100 për qind, ai mua nuk më beson as 0,1 për qind. Nuk i kanë folur fjalë të mira për mua e unë nuk po kam qasje tek ai. Bëra përpjekje, e pranoj por, dëshpërimisht, dështova; e luta një palaço nga oborri mbretëror i Hashimit që të hyjë brenda edhe si ndihmës-palaço, kurse ai më tha: hup more hashkalia i drejt, po ti asgjë shqiptare nuk ke përveç se e flet gjuhën shqipe! Ma tha këtë njëri që nënën ia kishte shkërdhyer Dragani, kurse gruan ia kishte përpunuar seksualisht Millani! Po me rëndësi që Hashimi ka përkrahje pa asnjë mëdyshje nga Enver Pont Pilati dhe Edvini nga Lazarati sikur edhe nga Aca i Tashmajdanit; Begja i Kazakistanit, Shpendkeqi nga Zveçani, Dodiku nga Banjalluka, Frederiçka nga Svetozareva dhe Johani nga Smedereva.

**Si të mbrohet Kosova:** Shumë lehtë; mos të kërkohet asgjë, por as të mos premtohet asgjë. Më shumë se 100 shtete na kanë njohur me këta kufij, plus edhe dy shtete do të na njohin shpejt sipas Gjet Pacollit (mbase më 1 prill 2020), prandaj t'i mbrojmë këta kufij. Nëse kërkohen gërshtërit për kufij të tjerë, edhe ne, pajtohemi, i hyjmë Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Maqedonisë dhe... vazhdojmë pastaj. Si hap i parë e që do t'i ndihmonte Kosovës është që Hashim Thaçi të tërhiqet dhe, në vend se të luajë koçe me ne, le të luajë me nipa dhe mbesa sepse ngadalë po bëhet gjysh. Pastaj, nëse më lejohet ta citojë plakën legjen-

dare nga Shtimja; "na ke ndihmu, na ke ndihmu, na ke q... nënën". Mjafton kjo ndihmë!

**Tribunali Ndërkombëtar i Liverpoolit:** Po flitet për formimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që i ka bërë Serbia në Kosovë e që është bukur vështirë të realizohet. Së paku, jo shpejt. Kam një propozim tjetër që mund të realizohet shpejt dhe se provat janë shumë konkrete dhe të pamohueshme. Të formohet një Tribunal Ndërkombëtar në Liverpool, ku do të dënoheshin ekipi e Liverpoolit, trajneri Klopp, e sidomos Divak Origi dhe Xhorxho Vinjaldum, për faktin se u kanë shkaktuar vuarjet dhe kanë terrorizuar miliona dhe miliona përkras të Barcelonës më datë 7 maj 2019. Vendi i torturimit, Liverpool, Amfield Road. Koha e torturimit, nga ora 21.00 - 22.45 dhe torturimi ende zgjatë. Pasojat janë të paparashikueshme, sidomos për Jetonin, mikun tim që po mendon se është një ëndërr dhe se në realitet kjo nuk mund të ndodhë! Unë, si taksa 100 për qind e Ramushit, jam 100 për qind me Barcelonën. Shpresoj se në karrigen e të akuzuarve do të jetë edhe ish-trajneri i Barçës, Valverde dhe jam i sigurt se edhe po të ishte Llapit, me Tahir Batatinën duke luajtur, nuk do të pësonte asi debakli. Duket se Barcelona ka nevojë patologjike që çdo vit kur të eliminohet, nuk eliminohet me një gol apo penalti, por se humb ndershëm si burrat e ndershëm të Gjylekarit sikur që ishte puna e Romës dhe Juventusit. Megjithatë, jam me Barçën edhe në këtë kohë të tragjedisë së përgjithshme. Urime të sinqerta Liverpool! Uroj të bëhesh kampion i Evropës! Barça duhet t'i shesë Kutinjon, Suarezin, Piken, Busketin, Rakitiqin dhe disa të tjerë sikur që duhet ta falë (nëse dikush e pranon) Valverden. jua them se më ka habitur strategjia e Valverdes, në kohën kur Barçës i dilte flaka në të gjitha anët, ai hidhte benzinë! E pabesueshme!



## Vazhdojnë kontrollet sistematike të mjekëve në shkollat fillore të Kamenicës

**KAMENICË, 9 MAJ (ER)** - Mjekët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kamenicë kanë bërë kontrollimin sistematik të nxënësve të klasave të pesta të Shkollës Fillore "Fan S. Noli" në Kamenicë. Gjatë kësaj vizite i pranishëm ka qenë edhe drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Dritan Maliqi, bashkë

me ushtruesin e detyrës së drejtorit të QKMF-së, Ylber Thaçi dhe shefin e Kabinetit të kryetarit Kamenicës, Meriton Ramabaja. Ky kontroll u është bërë nxënësve me qëllim të informimit dhe zbulimit të problemeve të mundshme që ata mund të hasin në shëndetin e tyre.

Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Dritan Maliqi, ka thënë se këto kontrolle janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme që të vazhdojnë edhe më tutje. Gjithashtu, ky projekt është një prej realizimeve që kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrioti, ka premtuar gjatë fushatës.

## Fillon mbjellja e luleve në hapësirat publike në Suharekë

**SUHAREKË, 9 MAJ (ER)** - Komuna e Suharekës, e cila drejtohet nga Bali Muharremaj, ka nisur mbjelljen e luleve në hapësirat publike në këtë qytet. Aksionit për mbjelljen e luleve në qytetin e Suharekës i është bashkuar kryetari i kësaj komune. Me këtë rast, Bali

Muharremaj ka theksuar se mbjellja e luleve do t'ia kthejë Suharekës pamjen e bukur në hapësirat publike. "Ka filluar mbjellja e luleve në qytet, e cila do ta kthejë pamjen e bukur në hapësirat publike", ka thënë Muharremaj.



## Jashari takon drejtorët e shkollave, flasin për procesin edukativo-arsimor



**SKENDERAJ, 9 MAJ (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe drejtori i Arsimit, Bekim Latifi, kanë mbajtur një takim me të gjithë drejtorët e shkollave të kësaj komune, me qëllim të diskutimit për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, si dhe për mbajtjen e garave të diturisë që organizohen nga koordinatori nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe

Teknologjisë (MASHT). Garat e diturisë do të mbahen më 11 maj 2019 (ditën e shtunë) në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, nga klasa I deri në klasën XII nëpër shkollat e Skenderajt dhe do të mbikëqyren nga Drejtoria Komunale e Arsimit. Me rastin e mbajtjes së garës për dituri janë krijuar mundësitë dhe hapësirat për aktivitete brenda dhe jashtëkurrikulare për nxënësit.

## Asfaltohet shtresa e dytë e rrugës në fshatin Muhoc të Ferizajt

**Ferizaj, 9 maj (ER)** - Në fshatin Muhoc të Komunës së Ferizajt ka përfunduar projekti për asfaltimin e shtresës së dytë të rrugës së këtij fshati. "Me një mbikëqyrje profesionale dhe standarde të larta infrastrukturore u përfundua edhe ky projekt që ka një kosto prej 32 000 eurosh. Gjatësia e rrugës së asfaltuar në fshatin Muhoc është 425 metra dhe gjerësi 5 metra", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Arbër Bytyqi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturrës, ka thënë se ky vit është dyfishi i dinamikës së punëve dhe projekteve infrastrukturore që janë realizuar



gjatë vitit 2018, duke finalizuar kështu një cikël të madh investimesh dhe veprash infrastrukturore me rëndësi jetike dhe

zhvillimore për qytetin dhe qytetarët.

## Komuna e Klinës mbjellë 200 fidanë të llojit pishë

**KLINË, 9 MAJ (ER)** - Në Kompleksin Memorial "Kodra e Kuqe" në Komunën e Klinës është bërë mbjellja e 200 fidanëve të llojit pishë. Në fillimin e punimeve ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, bashkë me bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së. Me këtë rast, kryetari Elezaj ka theksuar se institucionet duhet të përkujdesen në mënyrë të veçantë për ata që sakrifkuan çdo gjë për lirinë e vendit. Po ashtu, ai ka



thënë se synojnë që brenda vitit ta fillojnë projektin për përkujdesjen për varrezat në tërë komunën e Klinës. Ky projekt nga Komuna e Klinës do të vazhdojë gjatë tërë vitit edhe me mbjelljen e 300 fidanëve të tjera në lokacione të ndryshme.

## Liderët evropianë zotohen për mbrojtje të demokracisë

**BUKURESHIT, 9 MAJ** - Liderët evropianë kanë thënë përmes një deklarate më 9 maj se mbesin të përkushtuar për të kryer reforma në disa fusha dhe për ta mbrojtur demokracinë e sundimin e ligjit. Kryeministrja britanike Theresa May nuk ka qenë pjesë e samitit joformal që po mbahet në Rumani, vend në të cilin liderët evropianë kanë diskutuar të ardhmen e BE-së, pas largimit të Britanisë nga ky bllok. Ky samit është duke u zhvilluar

vetëm dy javë para mbajtjes së zgjedhjeve evropiane, proces i cili rrezikon të rezultojë me rritje të partive populiste dhe atyre euroskeptike. Në këtë takim është miratuar një deklaratë me 10 pika, të cilat për disa diplomatë në Bruksel janë konsideruar si "10 komanda" për Komisionin e ardhshëm Evropian. "Ne do të vazhdojmë të mbrojmë mënyrën tonë të jetesës, demokracinë dhe sundimin e ligjit", është thënë në deklaratë.

Pas miratimit të deklaratës, liderët kanë nisur diskutimet për një "agjendë strategjike", të udhëhequr nga presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk. Ku dokument do të diskutohet edhe në një tjetër samit që pritet të mbahet në fillim të muajit qershor, për të diskutuar se si rezultati zgjedhor do të ndikojë në strukturën e re të Komisionit Evropian. Megjithatë, pavarësisht prej nënshkrimit të deklaratës së



përbashkët, liderët e bllokut evropian janë duke shtyrë përpara agjendën e ndryshme shtetërore. Presidenti francez Emmanuel Macron është duke bërë fushatë

të zëshme për ambientin dhe klimën derisa kryeministri hungarez, Viktor Orban nuk po arrin pajtueshmëri me kolegët e tij sa iu përket çështjeve të migrimit.

## ShBA-ja i vë sanksione të reja Iranit, Teherani kërcënon

Shtëpia e Bardhë tha se sanksionet e reja godasin sektorët e çelikut, aluminit, bakrit dhe hekurit, që janë burime kryesore të të ardhurave në Iran, kurse ky i fundit kërcënoi se do të pasurojë uranium më pranë niveleve të armëve brenda 60 ditësh nëse fuqitë botërore dështojnë të negociojnë kushte të reja

**UASHINGTON, 9 MAJ** - Shtetet e Bashkuara shpallën sanksione të reja ndaj industrisë metalike të Iranit, pasi ky i fundit tha se i pezullon disa angazhime me marrëveshjen bërthamore të vitit 2015. Shtëpia e Bardhë tha se sanksionet e reja godasin sektorët e çelikut, aluminit, bakrit dhe hekurit, që janë burime kryesore të të ardhurave në Iran. Paraprakisht, Irani tha se nuk do ta shesë uraniumin e pasuruar dhe ujin e rëndë në vende të tjera, siç përcaktohet me marrëveshjen bërthamore midis Teheranit dhe gjashtë fuqive botërore. Ai, po

ashtu, kërcënoi se do të pasurojë uranium më pranë niveleve të armëve brenda 60 ditësh, nëse fuqitë botërore dështojnë të negociojnë kushte të reja. Këto zhvillime vijnë në përvjetorin e vendimit të presidentit amerikan Donald Trump për t'i tërhequr Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja e vitit 2015, e cila kishte për qëllim reduktimin e programit bërthamor të Iranit, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve kundër tij. Britania, Franca dhe Gjermania - palët e Evropës Perëndimore në paktin bërthamor - i kritikuan



hapat e Iranit dhe e paralajmëruan atë që të mos e braktisë marrëveshjen. Rusia, një tjetër nënshkruese e marrëveshjes, tha se Uashingtoni është përgjegjës për vendimin e Iranit. Përmes një deklarate, Trumpi tha se sanksionet e reja "godasin të ardhurat e Iranit nga eksporti i metaleve industriale dhe i paralajmërojnë vendet e tjera se çeliku dhe metalet e tjera të Iranit nuk do

të tolerohen në portet e tyre". Uashingtoni tashmë ka kufizuar eksportet e naftës së Iranit, që janë burimi më i madh i të ardhurave në këtë vend. "Teherani mund të presë veprime të tjera nëse nuk e ndryshon rrënjësisht sjelljen e tij", tha Trumpi, duke shtuar se ai është i hapur për bisedime. "Pres që një ditë t'i takoj udhëheqësit e Iranit për të hartuar një marrëveshje dhe, çfarë është më e rëndësishmja, të ndërmarrin

hapa për t'i dhënë Iranit të ardhmen që e meriton", tha presidenti amerikan. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se Uashingtoni do të presë dhe të shohë nëse Teherani i realizon kërcënimet e tij përpara se të ndërmarrë ndonjë hap tjetër. Sekretari i Jashtëm britanik, Jeremy Hunt, tha se kërcënimet e Iranit për ta rinisur pasurimin e uraniumit është një "hap i padëshirueshëm" dhe i bëri thirrje Republikës Islamike që të mos ndërmarrë hapa përshkallëzues. Ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas, shprehu shqetësim nga kërcënimet e Iranit dhe tha se "duhet të shmangen të gjithë hapat që mund ta rrezikojnë stabilitetin dhe sigurinë rajonale". Ministria e Mbrojtjes e Francës, Florence Parly, tha se evropianët duan ta mbajnë gjallë marrëveshjen bërthamore.

## Koreja e Veriut lëshon dy raketa me rreze të shkurtër veprimi



**PHENIAN, 9 MAJ** - Koreja e Veriut ka lëshuar ato çfarë duket të jenë dy raketa balistike me rreze të shkurtër veprimi, njoftoi të enjten Ushtria e Koresë së Jugut. Kjo është hera e dytë brenda një jave që Pheniani kryen prova me raketa. Një nga raketat përshkoi një distancë prej 420 kilometrash, tjetra prej 270 kilometrash, tha në një deklaratë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Koresë së Jugut. Raketat u nisën nga një provincë

në veriperëndim të vendit dhe u drejtuan për në lindje, thuhej gjithashtu në deklaratë. Sipas Qendrës për Studime Strategjike e Ndërkombëtare "Përtej Programit Paralel", në këtë provincë ndodhet një bazë raketash balistike me rreze të mesme veprimi (Nodong). Zyra e presidentit të Koresë së Jugut shprehu shqetësim rreth lëshimit të raketave të cilat duket të jenë me rreze të shkurtër veprimi

mi. Ai shtoi se kjo nuk ndihmon në zgjidhjen e tensioneve ushtarake ndër-koreane. Zyrtarët e Koresë së Jugut thonë se Seuli i ka forcuar përgatitjet në drejtim të sigurisë në rast lëshimi të raketave të tjera. Të shtunën Pheniani kreu prova me atë që sipas ekspertëve ishte si një raketë balistike me rreze të shkurtër veprimi. Kim Jong Un-i nuk kishte kryer prova me raketa që nga nëntori i vitit 2017.

## Shpallen fajtorë 14 të akuzuarit për grusht shteti në Mal të Zi

**PODGORICË, 9 MAJ** - Një gjykatë në Podgoricë shpalli fajtorë dhe i dënoi me gjithsej 69 vjet e shtatë muaj heqje lirie, 14 persona të akuzuar për një përpjekje për grusht shteti në prag të zgjedhjeve parlamentare të tetorit të vitit 2016 në Mal të Zi. Dy shtetas rusë, Eduard Shishmakov dhe Vladimir Popov, u dënuan në mungesë me 15, përkatësisht 12 vjet heqje lirie. Ish-shefi i xhandarmërisë serbe, Bratislav Dikiq u dënua me tetë vjet, Predrag Bogičević

me 7 vjet, Nemanja Ristić me 5 vjet heqje lirie, ndërsa dy udhëheqësit e opozitës Andrija Mandić dhe Milan Knezhević me nga 5 vjet heqje lirie. Trupi gjyqësor i drejtuar nga Suzana Mugosha, dënoi Branka Milićin me tre vjet heqje lirie, Dragan Maksićin me një vit e 9 muaj, Milan Dushić dhe Mihailo Čaxhenović u dënuan me nga një vit e 6 muaj dhe Kristina Hristić u dënua me një vit heqje lirie me kusht. Gjatë shpalljes së vendimit,

kryetarja e trupit gjyqësor, Suzana Mugosha, tha se "qëllimi i të akuzuarve ishte rrëzimi i dhunshëm i pushtetit në Mal të Zi". Podgorica zyrtare ka akuzuar nacionalistët serbë dhe rusë për komplot për të pushtuar parlamentin gjatë zgjedhjeve të vitit 2016, për të vrarë kryeministrin e atëhershëm, Millo Gjukanović dhe për të vendosur një udhëheqje pro-ruse në Mal të Zi. Dy rusët e dënuar në mungesë, sipas prokurorëve në Mal të Zi,



janë oficerë të shërbimit ushtarak rus të zbulimit. Moska ka hedhur poshtë mundësinë që

"mekanizmat shtetërorë rusë", të kenë qenë të përfshirë në përpjekje për grusht shteti.

E rrallë

## Boshatisen klasat, regjistrohen delet si nxënës

Një fshat i vogël në Alpet Franceze, Crets en Belledonne, po numëron delet për një arsye të veçantë. Ata i regjistrojnë kafshët në shkollë për ta kompensuar numrin e nxënësve në klasa. Shkolla Fillore "Jules Ferry" ka regjistruar të



martën 15 delet si nxënës për t'i përmbushur rregulloret franceze që përcaktojnë kuotat për numrin e nxënësve të kërkuar në një shkollë.

FOTO E DITES



Dy gra kalërojnë hipur mbi kuajt e tyre përmes fushave të luleve në Langenenslingen të Gjermanisë. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

E jashtëzakonshme

## Në ishullin Capri të Italisë nuk lejohen gjësendet plastike

Turistët që do ta vizitojnë ishullin Capri në Itali nuk duhet të marrin asgjë plastike me vete, ndryshe do ta pësojnë. Ligji i ri thekson se ndalohen çantat plastike, pjatat, gotat dhe çdo gjë tjetër. Nëse shihet dikush me to, mund të gjobitet me 500 euro. Ndalimi filloi këtë muaj me qëllim për ta mbrojtur bregun dhe tokën. Kryebashkiaku Giovanni de Martino e ka mirëpritur këtë vendim.



## BARSOLETA E DITËS



- Bir, a po m'i gjen 10 euro?
- Po more, veç tregomë ku të kanë rënë.
- O nuk më kanë rënë askund, por po t'i kërkoj hua.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

#### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 20:00

#### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.  
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

#### "THE KID WHO WOULD BE KING",

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.  
Regjia: Joe Cornish




Regjia: Joe Cornish

Në ora 22:00

#### "U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon  
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p><b>DASHI</b> Të gjitha ndjesitë e mira që ju karakterizojnë sot do të përthehen në një ide konkrete që do të doni ta zhvilloni sa më parë.</p>	 <p><b>DEMI</b> Keqkuptime në marrëdhënien prindër-fëmijë sot dhe shkakun duhet ta kërkonin te një neglizhencë e kohëve të fundit.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Fusha afektive do të jetë e mbushur sot me miqësi të reja dhe me ndjenja të këndshme që po ju ngacmojnë kureshtjen.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Kjo stinë ju ka bërë më të përkujdesur ndaj shëndetit dhe më të ndërgjegjshëm me aktivitetet që duhet të përmbyllni.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot do të gjendeni në situata të reja dhe plot surpriza që dita ju ofron pa pasur idenë nëse mund t'i përballoni ose jo.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Ditën sot e keni të ndarë në dy pjesë, në pjesën e parë ideoni dhe detajoni çdo plan tuajin, në të dytën filloni t'i vini në zbatim.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot do të karakterizoheni nga luhatje humori të theksuara dhe kjo gjë ju bën disi nervoz karshi personave tuaj të afërt.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Edhe pse ju jeni mjaft realist dhe vendosni gjithmonë me logjikë, sot do të lëkundeni nga ndjenjat dhe afeksioni i familjarëve për një çështje të caktuar.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Po ndërveproni në mënyrë të shkëlqyer me ambientin që ju rrethon. Sot do ta tërhiqni admirimin e një personi për të cilin ndjeni diçka.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Instinkti nuk ju lë të gaboni sot dhe ju jeni përballur me mjaft persona polemikë gjatë rrugës suaj sa të mund të dalloni ata që po ju cenojnë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Nuk keni shumë dilema për veprimet që bëni, por keni gjithmonë pjekurinë që të pyesni persona që kanë më shumë përvojë se ju.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot ndiheni shumë të mbushur dhe po e shikoni ditën plot ngjyra. Nuk e keni kuptuar ende këtë ndjesi plotësimi që po ju shoqëron.</p>

## Ed Sheeran dhe Justin Bieberi pritet të publikojnë këngë të re



**K**ëngëtari britanik Ed Sheeran dhe ai kanadez Justin Bieber kanë realizuar një bashkëpunim të ri muzikor. Kënga e dyshes quhet "I don't care" dhe do të publikohet këtë të premte. Lajmin e ka bërë me dije Ed Sheeran me anë të

një postimi në rrjetin social "Instagram". "Kënga ime me Justin Bieberin do të dalë të premten", ka shkruar këngëtari. Projekti i fundit muzikor i dyshes ka qenë "Love Yourself", ku teksti është i shkruar nga Sheeran dhe Bieber.

## Katy Perry vesh një kostum prej hamburgeri



**K**aty Perry, pas veshjes me llambadar në Met Gala që bëri t'i kthejë shumë sy në drejtim të saj, në festën pas saj pati edhe një kostum më 'ekstrem'. Ajo veshi një kostum gjigant me

hamburger të "Guccit". Në mbrëmjen e së hënës Perry në kostumin e saj pati të gjithë përbërësit e një hamburgeri: bukën, mish viçi, sallatë, domate, djathë, plus një shkop dhëmbësh përmbi.



## Publikohet fotografia e parë e fëmijës së Princit Harry dhe Meghan Markle

**P**rinc Harry dhe Meghan Markle kanë prezantuar para botës fëmijën e tyre të parë. "Ai ka temperamentin më të ëmbël, ai është vërtet i qetë, ai ka qenë ëndërr", ka thënë Meghan. Në një deklaratë nga Pallati Buckingham, familja

mbretërore ka njoftuar për emrin e fëmijës: "Duka dhe Dukeshja e Sussex janë të kënaqur që të bëjnë me dije se djalin e tyre e kanë quajtur Archie Harrison. Fëmija do të njihet si Archie Harrison Mountbatten-Wisdor".

## Roby Rose luan rolin "Batwoman"



**A**ktorja e njohur Roby Rose ka bërë me dije se do të aktrojë rolin më të ri të superheronjve "Batwoman". Sipas "Daily Mail", Rose është e lumtur që do të luajë

këtë rol, kjo pasi është një nga superheronjtë e parë që është lesbike. "Një rol i ri i superheronjve do të vijë në 'The CW'", ka shkruar Roby Rose në "Instagram".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**  
TEL: 045 82 82 82

# Hyseni: Hovi i Ferizajt ndalet në Mitrovicë

Hasan Hyseni i Trepçës '89 e ka paralajmëruar Ferizajn se pikët e plota nga ndeshja që zhvillohet sot (e premte) do të mbesin në Mitrovicë. "Ndeshja ndaj Ferizajt është e rëndësishme për të dy ekipet. Kundërshtari ynë është në formë të mirë dhe ka një ekip të mirë, por pikët do të mbesin në Mitrovicë. Për ne është shumë e rëndësishme se jemi të kompletuar për këtë ndeshje dhe të gjithë do të japim maksimumin për të arritur fitore", ka thënë Hyseni



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 9 MAJ** - Futbollisti i Trepçës '89, Hasan Hyseni, nuk është aspak i shqetësuar me formën e mirë që po kalon skuadra e Ferizajt, e cila në katër ndeshjet e fundit ka shënuar katër fitore. Hyseni të enjten për "Epokën e re" ka thënë se hovi i kësaj skuadre do të ndalet sot (e premte) kur do të përballet me Trepçën '89 në stadiumin "Riza Lushta". "Ndeshja ndaj Ferizajt është e rëndësishme për të dy ekipet. Kundërshtari ynë është në formë të mirë dhe ka një ekip të mirë, por pikët do të mbesin në Mitrovicë. Për ne është shumë e rëndësishme që jemi të kompletuar për këtë ndeshje dhe të gjithë do ta japim maksimumin për të arritur fitore", ka thënë Hyseni, i cili është shumë i bindur se '89-shi nuk do të ketë aspak problem mbetjen në elitën e futbollit të Kosovës. "Siç nuk kemi frikë nga kundërshtari i radhës, ashtu s'kemi as nga rënia prej Superligës. Kemi skuadër me

potencial të madh dhe nuk do të jemi të rrezikuar nga rënia, kurse synim në këtë edicion e kemi rrëmbimin e Kupës", ka shtuar ai. Për ndeshjen që zhvillohet në Mitrovicë ka folur për gazetë edhe një nga lojtarët më të mirë të Ferizajt, Qëndrim Dautaj. Ky i fundit ka thënë se edhe një barazim do të ishte i mirëseardhur për skuadrën e drejtuar nga Bylbyl Sokoli. "Ndeshje e vështirë na pret ndaj Trepçës '89 për faktin se të dyja skuadrat nuk janë rehat në tabelën e klasifikimit, por ne jemi të vendosur dhe do të angazhohemi që të marrim një rezultat pozitiv", ka thënë Dautaj. Aktualisht Trepça '89 është e pesta në renditjen tabelore me 39 pikë, kurse skuadra e Ferizajt zë vendin e tetë në Superligë me 37 pikë të grumbulluara, dy më shumë se Ballkani dhe tri më shumë se Gjilani që janë në zonën e barazhit. Krahas kësaj ndeshje, sot (e shtunë) zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera të javës së 31-të, kurse takohen: Flamurtari-Drenica dhe Ballkani-Gjilani.

## IPKO SUPERLIGA

Të premtën takohen:  
Flamurtari - Drenica  
Ballkani - Gjilani  
Trepça '89 - Ferizaj

Të shtunën takohen:  
Prishtina - Llapi  
Feronikeli - Drita  
Liria - KEK-u

### TABELA

1. Feronikeli	30	71 pikë
2. Llapi	30	69
3. Prishtina	30	69
4. Drita	30	48
5. Trepça '89	30	39
6. Drenica	30	38
7. Flamurtari	30	38
8. Ferizaj	30	37
9. Ballkani	30	36
10. Gjilani	30	35
11. Liria	30	25
12. KEK-u	30	1

## SHKURT

### Sonte finalja e katërt Rahoveci - Prishtina

Ndeshja e katërt finale në Superligën e Kosovës në basketboll në mes të Prishtinës dhe Rahovecit zhvillohet sonte (e premte) nga ora 20:30. Aktualisht kryeqytetasit janë në epërsi 2-1 dhe në rast se arrijnë fitore sonte në Rahovec do të kurorëzohen me titullin e kampionit, ndërsa në rast të fitores së Rahovecit, ndeshja e pestë do të zhvillohet në Prishtinë, ku edhe do të vendoset titulli i kampionit.

### Kuka: Populli shqiptar e ka Majlindën dhuratë nga Zoti

Xhudistja Majlinda Kelmendi të enjten e ka festuar ditëlindjen e 28, kurse me këtë rast ka marrë një urim special nga trajneri Driton Kuka. Ky i fundit ka shkruar në "Facebook" se populli shqiptar e ka Majlindën dhuratë nga Zoti. "Urime Majlinda! Rrofsh edhe 100 vjet të tjera. Kampionia jonë olimpikë sot feston ditëlindjen. Me punë, si gjithmonë, edhe sot. Majlinda është emblema më e mirë shqiptare e lirisë sonë të shtrenjtë. E kemi dhuratë nga Zoti për popullin shqiptar, për shpresën për një të ardhme. Krenar dhe mirënjohës tërë jetën", ka shkruar Kuka.

### Agim Agushi dhe Bujar Ajeti synojnë ta thyejnë rekordin 'Guinness'

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës po organizon garën për thyerjen e rekordit "Guinness" në disiplinën "Mbajtje e topit me kokë në çifte", me zhonglerët Agim Agushi dhe Bujar Ajeti. Kjo garë do të mbahet më 10 maj 2019 në orën 10:30, para Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani" në Prishtinë. Agim Agushi së bashku me nipin e vet, Bujar Ajetin, e kanë vendosur rekordin "Guinness" në disiplinën "Mbajtje e topit me kokë në çifte" në vitin 2015.

### Moura: Ky është momenti më i mirë në jetën time

Heroi i Tottenhamit në gjysmëfinalen kundër Ajaxit, Lucas Moura, mbeti në vështirësi duke i shpjeguar emocionet pas tre golave të shënuara që ia siguruan kualifikimin në finale të Ligës së Kampionëve. "Është e pamundur ta përshkruaj atë që po e ndiej. Jam shumë i lumtur dhe shumë krenar me bashkëlojtarët e mi. Gjithmonë besoj në këtë moment. Ne dhamë gjithçka në fushë. E meritoni këtë gjë. Jemi si familje. Është e pamundur të shpjegohet. Kjo është një dhuratë e madhe nga Zoti që unë dua ta ndaj me bashkëlojtarët, shokët dhe familjen time. Nuk është vetëm merita ime, por e bashkëlojtarëve të mi dhe punës ekipore", ka thënë Moura.

## Florent Hadergjonaj i bashkohet Kosovës

Prishtinë, 9 maj - Florent Hadergjonaj edhe zyrtarisht e ka pranuar ftesën e Kosovës për të qenë pjesë e saj. Futbollisti që ka luajtur nëpër të gjitha grupmoshat e Zvicrës nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se e ka marrë pasaportën e Kosovës dhe se tash do t'i mbrojë ngjyrat e saj. "Përshëndetje të dashur miq. Dua

t'ju njoftoj se tani sapo kam marrë pasaportën e Kosovës dhe jam gati që të luaj me fanellën më të bukur në botë. Dëshira ime gjithmonë ka qenë të luaj për vendlindjen time, mirëpo është dashur të vijë koha e duhur. Jam grumbulluar edhe nga Zvicra nga të gjitha grupmoshat deri në ekipin e parë. Nga tani, unë Florent Hadergjonaj jam një

'Dardan' plus për trajnerin Bernard Challandes dhe do ta jap gjithmonë maksimumin për Kosovën tonë", ka shkruar Hadergjonaj, i cili në këtë edicion të Ligës Premierie ka luajtur në 24 ndeshje me Huddersfieldin, 19 prej të cilave ka qenë titullar, kurse në fushën e gjelbër i ka kaluar 1 840 minuta.





## Gara e Brazilit zhvendoset nga Sao Paulo në Rio de Janeiro

RIO DE JANEIRO, 9 MAJ - Çmimi i Madh i Brazilit në Botërorin e Formula 1 duke nisur nga viti 2020 nuk do të zhvendoset nga Sao Paulo, por në Rio De Janeiro. Ai që e konfirmoi këtë lajm është vetë presidenti i vendit, Jair Bolsonaro, që do të thotë se pista e Interlagos ku janë zhvilluar

garat e këtij kampionati deri tani do të braktiset përfundimisht. "Pista e re do të ndërtohet në harkun e 6-7 muajve nga nisja e punimeve, kështu që gara e Brazilit në Formula 1 do të mbahet në Rio De Janeiro. Kjo do të sjellë një rritje të vendeve të punës, si dhe përfitime në

sektorin e Turizmit", ka thënë Bolsonaro. Mësohet se pista e re e Formula 1 do të ndërtohet në zonën Deodoro, në pjesën perëndimore të qytetit. Çmimi i madh i Brazilit është pjesë e Botërorit të Formula 1 që nga viti 1973. Të 36 garat janë mbajtur në pistën e

Interlagos të Sao Paulos, ashtu sikurse do të ndodhë edhe për 2019-n. Projekti i ri do ta përfshijë edhe hyrjen e Botërorit të MotoGP në vendin amerikan. Ideja është që të krijohet një pistë si ajo e Barcelonës, Silverstone në Angli apo Austin në Texas të ShBA-së.



## Beqiraj: Ndeshja ndaj Kosovës, e veçantë për mua, por dua fitore



PRISHTINË, 9 MAJ - Fatos Beqiraj ka folur për ndeshjen ndaj Kosovës të cilën e konsideron speciale për të. Sidoqoftë, futbollisti nga Kosova thotë se do ta japë më të mirën nga vetja për t'i mposhtur "Dardanët" me Malin e Zi. Futbollisti nga Peja do të luajë kundër vendit ku u lind dhe rrit pasi, siç dihet, që një kohë të

gjatë ai e përfaqëson Malin e Zi. Në një intervistë për mediumin malazez "CDM", sulmuesi pejan ka folur edhe për duelin me "Dardanët", i cili do të zhvillohet muajin e ardhshëm, respektivisht më 7 qershor, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2020. "Ndaj Kosovës nuk do të jetë një

ndeshje e zakonshme për mua, sepse luaj kundër vendit në të cilin jam lindur. Familja ime jeton atje. Por, unë e shikoj ndeshjen në aspektin sportiv. Do ta bëj më të mirën për të fituar", ka thënë Beqiraj. "Ne duhet ta marrim seriozisht Kosovën, sepse është organizuar në nivele të larta. Natyrisht, ne mund të fitojmë. Gjithashtu, do të jetë e bukur të udhëtojmë në Republikën Çeke pas fitores ndaj Kosovës", ka shtuar ish-sulmuesi i Besës.

Ndërsa sulmuesi i rrezikshëm ka folur në përgjithësi për grupin në të cilin gjendet Mali i Zi. Ai nuk mendon se gjithçka do të marrë fund me ndeshjet e qershorit. "Anglia është favorite absolute në grupin tonë dhe e kemi arritur një rezultat të mirë kundër Bullgarisë, përkundër faktit se nuk kemi luajtur mirë. Çfarëdo që ndodh në muajin qershor nuk do të marrë fund asgjë. Sidoqoftë, rezultatet pozitive muajin e ardhshëm mund të na japin krahë", ka deklaruar Beqiraj.

## Milwaukee, finalist i parë në Lindje, Golden State rikthehet te fitorja

MILWAUKEE, 9 MAJ - Skuadra e Milwaukee është finalistja e parë e "play-off"-it në Konferencën e Lindjes në NBA. Bucks fitoi me lehtësi 116-91 ndaj Bostonit në gjysmëfinalen e pestë, duke fituar 4-1 serinë e takimeve. Një ndeshje që ishte një formalitet për Milwaukee, që para tifozëve të vet nuk zhgënjëu. Vendësit u shkëputën gradualisht nga perioda në periodë, duke mos e vënë në asnjë moment në diskutim fitoren. Shtatë lojtarë të Milwaukee realizuan mbi 10 pikë, me të zakonshmin Giannis Antetokounmpo që realizoi 20 pikë, mbështetur nga Middleton me 19 dhe Bledsoe me 18 pikë. Bostoni ishte në një ditë të keqe, duke gabuar shumë në gjuajtje. Në Perëndim, skuadra kampione e Golden State fitoi 104-99 ndaj Houstonit në ndeshjen e pestë gjysmëfinale, duke udhëhequr 3-2 serinë. Faktori fushë vendimtar edhe këtë herë, me Warriorsin që triumfoi në shtëpi. Edhe pse Golden State u shkëput 20 pikë në periodën e dytë, sfida u bë



shumë interesante në periodën e katërt. Rocketsi rikuperoi menjëherë, madje doli edhe në avantazh. Gjithsesi, minutat e fundit i japin fitoren skuadrës së Warriorsit, më e kujdesshme në fushë. Ai që bëri diferencën në

këtë sfidë ishte Klay Thompson, që realizoi 27 pikë, mbështetur nga Curry me 25 dhe Duranti me 21 pikë. Në kahun tjetër u dallua Hardeni që realizoi 31 pikë, por që s'mjaftuan për ta shmangur humbjen.

### KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Boston	116-91	(4-1)
Toronto - Philadelphia		(3-2)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Golden State - Houston	104-99	(3-2)
Portland - Denver		(2-3)

### SHKURT

#### Pochettino: Faleminderit futboll

Trajneri i Tottenhamit, Mauricio Pochettino, nuk i ka përmbytur lotët pas kualifikimit historik në finale të Ligës së Kampionëve. Skuadra e tij e përmbysti Ajaxin, duke fituar në Amsterdam me rezultat prej 2 me 3. "Kam shumë vështirësi të flas. Ky është një emocion fantastik. Faleminderit futboll. Lojtarët e mi janë heronj. Në sezonin e kaluar u thashë të gjithëve se ky grup është heroik. Në pjesën e dytë ishin të jashtëzakonshëm. Këto emocione pa futbollin do të ishin të pamundura. Faleminderit të gjithëve që keni besuar tek ne. Është shumë e vështirë ta përshkruajmë këtë me fjalë", ka thënë Pochettino për "BT Sport". Ai ka shtuar se "të gjithë janë heronj, por Lucas Moura është superheroi".

#### De Ligt: Marr përgjegjësitë për gabimin në golin e fundit

Mund të ishte heroi i mbrëmjes për mënyrën se si u nis ndeshja, por Matthijs De Ligt tregon dëshpërimin e tij dhe të gjithë Ajaxit pas eliminimit në minutën e fundit nga Tottenham Hotspur. Kapiteni i holandezëve thotë se skuadra e tij nuk e meritoi eliminimin në këtë mënyrë dhe thekson se në pjesën e dytë vuajti presionin e kundërshtarëve. "Ne luajtëm mirë në pjesën e parë të ndeshjes, ndërsa në të dytën patëm shumë presion dhe nuk po dilnim dot në lojën tonë. E kishim të vështirë ta ndalnim vullin e tyre edhe pse, në fund të fundit, mendoj se kemi bërë më mirë në të dyja ndeshjet. Meritonim të shkonim në finale", ka thënë De Ligt. I pyetur për mbështetjen e tifozëve, ai ka thënë vetëm fjalë të mira. "Është fenomenale mënyra se si na duartrokitën tifozët tanë, edhe pasi ne u eliminuam në fund. Ishim aq afër finales, por nuk ia dolëm. Më vjen shumë keq. Marr përgjegjësitë për gabimin në golin e fundit", ka shtuar De Ligt. "Duhet të kishim shënuar dhe ta kishim siguruar kualifikimin në finale. Skuadra pati raste, por i shpërdoroi ato. Duhet të ishim më të saktë përpara portës", ka përfunduar De Ligt.

#### Allegri do të largohet nga Juventusit

Massimiliano Allegri nuk do të jetë më trajner i Juventusit pas përfundimit të këtij sezoni. Edhe pse e kishte konfirmuar gatishmërinë për të qëndruar në Torino, duke u konfirmuar në detyrë për edicionin e ri edhe nga presidenti Andrea Agnelli, gjithçka ka ndryshuar. "Corriere della Sera" raporton se Allegri u ka thënë miqve se: "Koha ime këtu ka përfunduar". Sinjal i qartë i largimit nga Juventus, në pritje të zyrtarizimit, pas takimit me presidentin Agnelli. Allegri mund të emërohet trajner i Paris Saint-Germain.

#### Roma synon Gasperinin ose Wengerin

Edhe pse në krye të skuadrës kanë një strateg si Claudio Ranieri, drejtuesit e Romës vazhdojnë të kërkojnë një trajner të ri për sezonin e ardhshëm. 67-vjeçari e mori drejtimin e verdhekuqve më 8 mars të këtij viti, pas shkarkimit të Di Francescos, por do të qëndrojë në krye të ekipit deri në fund të sezonit. Dy alternativat për stolin e kryeqytetasve janë Gian Piero Gasperini, që aktualisht drejton skuadrën e Atalantës dhe Arsene Wenger, i cili nuk drejton një ekip që pas largimit nga Arsenali, skuadër ku qëndroi për 22 vjet.

#### Shevchenko në të ardhmen synohen të bëhet trajner i Milanit

